DEMOS Decentralisation and Municipal Support


HELVETAS KOSOVO

Anketa mbi kënaqshmërinë e qytetarëve 2023





ANKETA MBI KËNAQSHMËRINË E QYTETARËVE 2023



Mars 2024

Ky raport është përgatitur nga UBO Consulting për projektin DEMOS, zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation.

MOHIM: Gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Zyrës së BE-së në Kosovë, qeverive të Zvicrës dhe Suedisë, si dhe të Helvetas Swiss Intercooperation.

Për këtë dokument nuk ka të drejta autoriale. Përmbajtja e këtij raporti mund të përdoret pjesërisht ose plotësisht pa lejen paraprake të Helvetas Swiss Intercooperation në Kosovë. Burimi i tij, megjithatë, duhet cituar.

Mars 2024, Prishtinë, Kosovë

PERMBAJTJA

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE 6

Gjetjet kryesore 6

HYRJE 10

METODOLOGJIA 11

Metodologjia sasiore 11

Qasje cilësore 11

PERCEPTIMETE QYTETARËVE 13

QASJA NË INFORMACION 14

PJESËMARRJA QYTETARE (ANGAZHIMI) 22

ROLI I KUVENDIT KOMUNAL 31

MENAXHIMI I KOMUNËS 35

OFRIMI I SHËRBIMIT 41

KËNAQSHMËRIA E PËRGJITHSHME ME KOMUNAT 45

PËRFUNDIMI 49

ANEKSE 51

Krostabulimet sipas komunave 51

PYETËSORI I ANKETËS 91

UDHËZUESI I DISKUTIMIT NË FOKUS GRUP 100

Lista e figurave

Figura 1. Sa jeni të informuar për vendimet që merr komuna juaj?....15
Figura 2. Në çfarë mënyra komunikohen këto vendime? 16
Figura 3. Në 12 muajt e fundit, a keni vizituar ndonjërën si në vijim?....17
Figura 4. Sa shpesh i keni vizituar platformat komunale në 12 muajt e fundit?....17
Figura 5. Për çfarë arsye?....18
Figura 6. Pse nuk keni vizituar asnjë nga platformat komunale? 19
Figura 7. A e keni gjetur informacionin/shërbimin e kërkuar?....20
Figura 8. Sa lehtë e keni gjetur informacionin që ju nevojitej?....20
Figura 9. Sa i kuptueshëm ka qenë informacioni i publikuar nga komuna që e keni gjetur? 21
Figura 10. Si keni ndërvepruar me komunën tuaj në 12 muajt e fundit (përveç gjatë fushatës elektorale)?....23
Figura 11. A keni ngritur ndonjë çështje specifike gjatë këtyre takimeve individuale? (n=467) 23
Figura 13. Çfarë çështjesh keni ngritur në komunë? 24
Figura 12. A keni ngritur ndonjë çështje specifike gjatë këtyre nismave të përbashkëta të komunitetit? (n=360) 24
Figura 14. Pasi që ngritët një çështje (nga pyetja 8a), a iu përgjigj komuna çështjes që ngritët? 25
Figura 15. Sa keni qenë të kënaqur me reagimin e komunës për çështjen që ngritët? 26
Figura 16. Pse nuk ishit të kënaqur me përgjigjen e komunës?....27
Figura 17. Si ju përfshin komuna gjatë takimeve publike?....27
Figura 18. Deri në çfarë mase pajtoheni që autoritetet komunale marrin parasysh sugjerimet e pjesëmarrësve gjatë takimeve publike? 28
Figura 19. A do të ishit të gatshëm të përdorni platformat dixhitale për të komunikuar/ndërvepruar me komunën tuaj? 30
Figura 20. A keni informacion se si ndahet buxheti komunal?....30
Figura 21. Sa jeni të kënaqur me përcaktimin e prioriteteve në kuadër të buxhetit komunal? 31
Figura 22. Sa jeni të vetëdijshëm për rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të kuvendit komunal? 32
Figura 23. A keni takuar ndonjë anëtar të kuvendit komunal në 12 muajt e fundit për të diskutuar çështje të përbashkëta publike?....33
Figura 24. A keni marrë pjesë në ndonjë seancë të Kuvendit Komunal në 12 muajt e fundit?....34
Figura 25. Sa shpesh keni marrë pjesë në këto seanca?....34
Figura 26. Cila është arsyeja? 35
Figura 27. Deri në çfarë mase pajtoheni që Kuvendi i Komunës arrin të mbajë përgjegjës ekzekutivin e komunës (Kryetarin e komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale)?....35
Figura 28. Sa jeni të kënaqur me menaxhimin e buxhetit komunal? 36
Figura 29. Sa jeni të kënaqur me projektet/punimet e infrastrukturës publike në komunën tuaj?....37
Figura 30. Sipas jush, cilat kritere merren parasysh gjatë procesit të rekrutimit të punonjësve në komunë?....39
Figura 31. A mendoni se komuna juaj promovon një mjedis komunal që është gjithëpërfshirës dhe pranues për të gjithë (pavarësisht gjinisë, përkatësisë etnike, (pa)aftësisë, etj.)? 40

Figura 32. A konsideroni se komuna juaj u ofron grupeve të ndryshme të margjinalizuara mundësi të barabarta për pozita udhëheqëse (arsim, shëndetësi, institucione kulturore dhe pozita politike në komunë)?....41
Figura 33. A keni përdorur shërbimet komunale të mëposhtme në 12 muajt e fundit? 43
Figura 34. Sa jeni të kënaqur me planifikimin hapësinor (zhvillimi komunal dhe planifikimi i përdorimit të tokës)? 45
Figura 35. Ju lutemi vlerësoni nivelin tuaj të kënaqshmërisë si në vijim: 48
Figura 36. Në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 tregon "Plotësisht të pakënaqur" dhe 5 tregon "Plotësisht të kënaqur", ju lutem vlerësoni kënaqshmërinë tuaj me aspektet e mëposhtme të jetesës në komunën tuaj:....49
Figura 37. A mendoni se komuna juaj është në drejtimin e duhur për të qenë një vend më i mirë pas 5 vitesh? 50
Figura 38. A jeni në dijeni të ekzistencën së këshillave lokale në komunën tuaj? 50

Përmbledhja ekzekutive

Anketa e Kënaqshmërisë së Qytetarëve 2023, një komponent kryesor i projektit DEMOS III, luan një rol të rëndësishëm në kuptimin e pikëpamjeve të qytetarëve të Kosovës për qeverisjen lokale dhe shërbimet e ofruara. Duke u thelluar në pikëpamjet dhe perceptimet e tyre, kjo anketë ofron informata që janë thelbësore në forcimin e përpjekjeve të Kosovës drejt përmirësimit të qeverisjes demokratike. Një analizë e të dhënave të mbledhura nga Anketa e Kënaqshmërisë së Qytetarëve realizuar në vitin 2021 dhe të dhënave të mbledhura nga anketa e vitit 2023 zbulon tendenca interesante në nivelet e kënaqshmërisë dhe të perceptimeve në lidhje me cilësinë e shërbimeve, administratën lokale, kuvendin komunal dhe punën e kryetarit të komunës. Duke krahasuar rezultatet e të dy anketave, është e mundur të identifikohen fushat e përmirësimit, si dhe fushat ku nivelet e kënaqshmërisë kanë mbetur të qëndrueshme ose kanë rënë.

I strukturuar në gjashtë seksione (pjesë), raporti mbulon **Qasje në informacion, Pjesëmarrja e qytetarëve, Roli i Kuvendit Komunal, Menaxhimi komunal, Ofrimi i shërbimeve** dhe **Kënaqshmërinë e përgjithshme**. Kombinimi i të dhënave sasiore dhe cilësore ofron një kuptim gjithëpërfshirës të perceptimeve të qytetarëve.

Gjetjet kryesore

Në vijim bëhet përmbledhja e gjetjeve kryesore nga anketa sasiore dhe diskutimeve në fokus grupe.

- Edhe pse 67% e të anketuarve në vitin 2023 pohojnë se **janë në dijeni për vendimet e komunave të tyre**, ka pasur një rënie të dukshme nga 78% e raportuar në vitin 2021. Nga ana tjetër, përqindja e të anketuarve që tregojnë **mungesë informacioni nge komuna e tyre** është rritur në 33%, nga 21% në vitin 2021. Vendimet komunale **komunikohen kryesisht** në mënyrë jo-formale - prej njërit tek tjetri - (49%), Facebook (47%) dhe TV/Radio lokale (44%). Shumica e pjesëmarrësve që morën pjesë në diskutimet e fokus grupeve raportuan gjithashtu se më shumë përdorin TV/Radio si dhe mediat sociale për t›u informuar pasiqë ata e **perceptojnë faqen e internetit të komunës si të pabesueshme**. Shumica e të anketuarve, ose 58%, përmendin **hapjen e vendeve të punës si arsyen kryesore** për vizitën e tyre në platformat online të komunave, përcjellur nga **subvencionet** me rreth 30% të respondetëve dhe **konusltimet publike** me rreth 20%.

Pavarësisht se gati shumica e respondentëve ishin të informuar për vendimet e komunës, 83% e të anketuarve kanë pohuar se nuk kanë asnjë ndërveprim me komunën e tyre në 12 muajt e fundit, krahasuar me 74% në vitin 2021. Pjesëmarrja në takime publike është ulur ndjeshëm nga 16% në 2021 në 5% në 2023, dhe takimet individuale kanë rënë nga 13% në 7%. Nismat e përbashkëta të komunitetit u ulën nga 12% në 5%, duke reduktuar përpjekjet bashkëpunuese të komunitetit.

- **Përdorimi i teknologjisë dixhitale** është përvetësuar nga më shumë se gjysma e të anketuarve (64%), duke treguar gatishmërinë për të përdorur **online platformat** për ndërveprimet komunale dhe qasjen në informacion.
- Shqetësimet në lidhje me infrastrukturën lokale, si rrugët dhe ndriçimi, mbetën prioritet, duke u rritur nga 53% në 65%. Në anën tjetër, **çështjet mjedisore u ulën** nga 47% në 20%. Ndryshime të dukshme janë vërejtur në arsim, shëndetësi, siguri publike dhe shqetësime kulturore/rekreative gjatë dy viteve. Njëkohësisht, 56% deklaruan se komuna iu përgjigj çështjeve të tyre të ngritura. Ku këta të fundit u përballen me një periudhë pritjeje mesatare prej 17 ditësh për të marrë një përgjigje. **Kënaqshmëria e përgjithshme me përgjigjet nga komuna** u rrit nga 61% në 2021 në 69% në 2023.
- Rreth 84% e të anketuarve kanë pohuar se komunat i **marrin parasysh sugjerimet e qytetarëve**, në krahasim me 74% në 2021. Në anën tjetër, pjesëmarrësit në fokus grupe kanë theksuar se nuk ndërveprojnë me komunat aq shumë si **pasojë e zhgënjimeve** sa i përket problemeve me të cilat janë ballafaquar. Sipas tyre, komunat nuk kanë ndihmuar në zgjidhjen e problemeve të tyre dhe nuk kanë marrë fare parasysh sugjerimet e tyre.
- **Informimi për ndarjen e buxhetit komunal** është ulur nga 23% në 2021, në 17% në 2023. Kënaqshmëria e përgjithshme në **përcaktimin e prioriteteve të buxhetit komunal** është rritur nga 77% në 2021, në 82% në 2023.
- Vërehet **një rënie e dukshme e vetëdijes në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të kuvendit komunal**, ku 26% e të anketuarve pohojnë se nuk janë aspak të vetëdijshëm për rolin e tyre në vitin 2023, krahasuar me 10% në vitin 2021.
- Shumica e të anketuarve **nuk kanë pasë takime me asambleistët e kuvendeve komunale**, duke rënë nga 29% në 2021, në 16% në 2023 të atyre që kanë takuar asambleistët në komunat e tyre.
- **Pjesëmarrja në seancat e Kuvendit Komunal pëson një rënie të ndjeshme**, nga 14% në vitin 2021, në 6% në vitin 2023. Mungesa e interesimit bëhet arsyeja kryesore për mospjesëmarrje, duke u rritur nga 43% në 2021, në 58% në 2023.
- Vërehet një rënie në perceptimin e aftësisë së Kuvendit Komunal për ta mbajtur ekzekutivin përgjegjës, me 64% pajtohen/plotësisht pajtohen në vitin 2023, krahasuar me 71% në 2021. Pjesëmarrësit e fokus grupeve theksuan se arsyeja kryesore është që shumica e anëtarëve të Kuvendeve Komunale janë aktiv vetëm gjatë zgjedhjeve me qëllimin e marrjes së votave dhe përzgjedhjes së tyre në Kuvend.

Ndërsa 56% pranojnë përpjekjet e vazhdueshme të institucioneve për përmirësimin e gjithëpërfshirjes, 17% shprehen negativ dhe 8% mbeten të pasigurt. Vetëm 18% e të anketuarve i shohin komunat e tyre si terësisht gjithëpërfshirëse. Në përgjithësi, të anketuarit shohin më shumë mundësi për pozita udhëheqëse për gratë (68%), për të moshuarit (52%), për personat me aftësi të kufizuara (53%) dhe grupet jo-shumicë (59%). Megjithatë, fokus grupet paraqitën se zakonisht, për shumicën e grupeve të margjinalizuara, shkalla e përfshirjes është korresponduese vetëm me marzhën ligjore të përfshirjes në punësimin komunal. Ndërkaq, sa i përket punësimit në sektorin privat, shumica e pjesëmarrësve kanë përshtypjen se mundësitë për grupet e margjinalizuar janë të pakëta; me përjashtim nga komuna e Prizrenit ku perceptimi është se

personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat etnike janë të punësuar në pozita të ndryshme.

- Pjesëmarrësit nga fokus grupet besojnë se **anëtarët e Kuvendeve ndikohen nga partitë e tyre politike**. Kjo nënkupton se parimet/ besimet e tyre politike partiake janë me më prioritet sesa interesat e qytetarëve që ata përfaqësojnë. Gjithashtu, ata shprehën se lidhjet familjare mund të kenë ndikim në punën brenda Kuvendeve Komunale. Kjo e fundit për shkak **të perceptimit se anëtarët e familjeve të anëtarëve të Kuvendeve mund të kenë trajtim preferencial** në lidhje me zgjidhjen e problemeve që mund të hasin.
- Kënaqshmëria me **menaxhimin e buxhetit komunal** mbetet e qëndrueshme me 63% në vitin 2023.
- Përkatësia politike (63%) dhe lidhjet familjare (64%) vazhdojnë të perceptohen si kritere domethënëse në **procesin e rekrutimit (punësimit)**. Arsimi dhe përvoja e punës ruajnë rëndësinë e tyre, me variacione të vogla.
- Është vërrejtur një rënie e përdorimit të shërbimeve administrative 77% në 2021, në 66% në 2023. **Shërbimet shëndetësore parësore pësuan një rritje** nga 69% në 73%, ndërsa hapësirat publike rriten ndjeshëm nga 49% në 68%. Shërbimet e arsimit para-universitar mbeten relativisht të qëndrueshme (47% në 49%), përdorimi i transportit publik rritet nga 40% në 44%, dhe lejet e ndërtimit ulen dukshëm nga 15% në 6%. Shërbimet e infrastrukturës rrugore, veçanërisht rrugët lokale dhe trotuaret, përdoren vazhdimisht nga 86% e të anketuarve.
- Sipas shumicës së pjesëmarrësve të fokus grupeve, **shërbimet administrative dhe shëndetësore janë përmirësuar më shumë duke theksuar specifikisht digjitalizimin** e shërbimeve administrative (eKosova). Ndërsa, infrastruktura rrugore mbetet një problem për disa komuna dhe lejet për ndërtim janë problematike dhe jo transparente sipas pjesëmarrësve nga Peja.

80% e të anketuarve kanë shprehur kënaqshmërinë me performancën e përgjithshme të komunave në vitin 2023, krahasuar me 75% në vitin 2021. Në vitin 2023, 83% e të anketuarve shprehën kënaqshmërinë me shërbimet komunale nga 78% në 2021. Kënaqshmëria me administratën lokale u rrit nga 75% (2021) në 78% në 2023, derisa kënaqshmëria me punën e Kryetarëve u rrit nga 66% (2021) në 73% në 2023. Kënaqshmëria me punën e kuvendeve komunale ka pësuar rënie nga 71% në 2021 në 69% në 2023. Kur vlerësohen nivelet e kombinuara të kënaqshmërisë (kuvendet komunale, shërbimet komunale, administrata lokale dhe kryetari i komunës), kënaqshmëria mesatare u rrit në 76% në vitin 2023, duke shënuar një rritje nga 73% në 2021.

- Nëse shikohen **dallimet gjinore**, **gratë shfaqin nivel më të ulët të kënaqshmërisë** me kryetarët e komunave, ku vetëm 29% janë plotësisht të kënaqura me punën e kryetarëve, në dallim nga burrat, nga të cilët **35% raportojnë se janë plotësisht të kënaqur me punën e kryetarit**. Vetëm **14% e grave shprehin kënaqshmëri të plotë me kuvendet komunale**, për dallim nga **17% e burrave që raportojnë të njëjtin nivel të kënaqshmërisë**. Po kështu, kur bëhet fjalë për **shërbimet komunale**, vetëm

27% e grave tregojnë kënaqshmëri, ndërsa burrat tregojnë një shkallë më të lartë me 35% kënaqshmëri të plotë me shërbime të ngjashme.

- Ka dallime të konsiderueshme të kënaqshmërisë ndërmjet të anketuarve në komuna, ku **banorët e Shtërpcës janë jashtëzakonisht të pakënaqur me Kryetarin e Komunës** (98%) dhe Kuvendin Komunal (96%). Ranillugu shfaq një ndarje të dukshme, me 75% të pakënaqshmërisë me Kuvendin Komunal. Në **Graçanicë, 73% e të anketuarve kanë shprehur pakënaqshmërinë me administratën lokale, derisa në Ranillug niveli i pakënaqshmërisë është 64%**.
- Pjesëmarrësit e fokus grupit nga **Gjakova janë më së shumti të kënaqur me Kryetarin e Komunës** përderisa ata treguan për transparencën e kryetarit dhe punën e tij të vazhdueshme në projekte. Kjo është e kundërt me pjesëmarrësit nga **Peja të cilët nuk ishin të kënaqur me Kryetarin** duke qenë se ata drejtonin përgjegjësinë për shumicën e shërbimeve drejtpërdrejtë tek kryetari.
- Të anketuarit kanë shprehur një kënaqshmëri të moderuar në lidhje me aspektet e ndryshme të mjedisit jetësor: **cilësia e ajrit** (rezultati mesatar: 3.34 nga 5); **trafiku/komunikacioni** (rezultati mesatar: 2.94 nga 5); **menaxhimi i mbeturinave** (rezultati mesatar: 3.29 nga 5), **përpjekjet për mbrojtjen e mjedisit** (rezultati mesatar: 3.10 nga 5), dhe **menaxhimi i fatkeqësive** (rezultati mesatar: 3.03 nga 5).
- Pjesëmarrësit e fokus grupit në Prishtinë paraqitën cilësinë e ajrit dhe trafikun si një problem në rritje e sipër për shkak të ndryshimeve të mëdha (*rregullimit të shesheve*) në qytetet e që ka ndikim të madh në trafik. Ndërkaq, pjesëmarrësit në Pejë theksuan pakënaqshmërinë me menaxhimin e fatkeqësive në komunë.
- Një shumicë e konsiderueshme (78%) **shprehën optimizëm për trajektoren e ardhshme të komunës së tyre**, duke besuar se ajo po shkon në drejtimin e duhur për përmirësim.
- Vetëm **29% e të anketuarve ishin në dijeni të ekzistencës së këshillave lokale** në komunat e tyre, derisa **60% nuk ishin në dijeni** dhe 11% nuk ishin të sigurtë për ekzistencën e tyre. Zonat rurale demonstrojnë një ndërgjegjësim më të lartë (35%) për këshillat lokal në krahasim me zonat urbane (19%). Rreth 65% e të anketuarve nuk kanë ndërvepruar fare me këshillat e tyre përkatëse lokale në 12 muajt e fundit.

Hyrje

Anketa e Kënaqshmërisë së Qytetarëve shërben si një shqyrtim gjithëpërfshirës i pikëpamjeve dhe perceptimeve të qytetarëve të Kosovës lidhur me shërbimet publike dhe qeverisjen lokale. Duke analizuar tendencat dhe nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve, politikëbërësit dhe autoritetet komunale fitojnë njohuri të vlefshme në fushat e fuqisë dhe mundësive për përmirësim. Këto njohuri mund të informojnë ndërhyrjet e synuara që synojnë rritjen e ofrimit të shërbimeve, përmirësimin e praktikave të qeverisjes dhe përfundimisht rritjen e kënaqshmërisë së qytetarëve. Për më tepër, anketa mundëson një kuptim të nuancuar të tendencave dhe ndryshimeve në perceptimet e qytetarëve me kalimin e kohës. Duke ndjekur ndryshimet në nivelet e kënaqshmërisë dhe qëndrimet ndaj qeverisjes lokale, palët e interesuara mund të përshtatin strategjitë dhe politikat për të përmbushur më mirë nevojat në zhvillim të qytetarëve.

Në kuadër të programit DEMOS, Anketa e Kënaqshmërisë së Qytetarëve thellohet në aspektet kritike të funksionimit të komunave, duke ofruar njohuri të marra përmes përgjigjeve të anketës dhe diskutimeve në fokus grupe dhe duke krahasuar rezultatet me anketën e vitit 2021. Duke paraqitur rezultatet më relevante, ky raport synon të ofrojë pikëpamje të qytetarëve për performancën e komunave dhe zyrtarëve të tyre të zgjedhur. Supozimi themelor është se theksimi i çështjeve urgjente mund të stimulojë komunat që të përgjigjen në mënyrë pro-aktive. Qëllimi përfundimtar i këtij studimi është të nxisë përmirësime në cilësinë e shërbimeve, duke rritur kështu cilësinë e përgjithshme të jetës për të gjithë qytetarët anembanë Kosovës.

I strukturuar në gjashtë seksione kryesore: Qasja në informacion, Pjesëmarrja e qytetarëve, Roli i Kuvendit Komunal, Menaxhimi i Komunës, Ofrimi i Shërbimeve dhe Kënaqshmëria e Përgjithshme me Komunat - ky Raport i Anketës së Kënaqshmërisë së Qytetarëve kombinon të dhënat sasiore dhe cilësore për të ofruar një kuptim gjithëpërfshirës të perceptimeve dhe pritjeve, të qytetarëve të Kosovës.

Metodologjia

Anketa ka përdorur një metodologji të përzier, duke përdorur metoda sasiore dhe cilësore të mbledhjes së të dhënave. Detajet e metodologjisë janë përshkruar më poshtë.

Metodologjia sasiore

Anketa është realizuar nëpërmjet intervistave ballë-për ballë, duke përdorur teknikën CAPI (intervista personale të asistuara me kompjuter). Anketa është bazuar në mostrën prej **6,700 të anketuarve** në nivel komunal me 1% marzhë gabimi. Kjo anketë e gjerë mbuloi 38 komuna anembanë Kosovës, duke angazhuar të anketuarit me prejardhje të ndryshme, duke përfshirë shqiptarët, serbët dhe komunitetet tjera jo-shumicë. Konkretisht, pjesëmarrësit shqiptarë janë intervistuar në 35 komuna, ndërsa të anketuarit serbë janë përfaqësuar në 17 komuna. Përpunimi i të dhënave përdori softuerin e menaxhimit të anketave.

Korniza e mostrës është nxjerrë nga regjistrimi i vitit 2011, një format i standardizuar në hulumtimin e opinionit publik. Duke shfrytëzuar strukturën dhe shpërndarjen e popullsisë, kuotat u vendosën në bazë të përkatësisë etnike (me një mbivlerësim të komuniteteve pakicë), komunave dhe llojit të vendbanimit (urban dhe rural). Kjo strukturë lehtësoi një shtrirje të shtresuar në nivelin më të ulët të organizimit të mostrës sipas popullsisë.

Për të adresuar paraprakisht çështjet e mundshme gjatë administrimit të pyetësorit, UBO Consulting ka kryer një pilot test për të vërtetuar përmbajtjen dhe logjikën. Ky test vlerësoi besueshmërinë e pyetësorit dhe vlerësoi kohën e nevojshme për një intervistë të suksesshme, duke nxitur modifikimet e nevojshme.

UBO Consulting kreu studimin në terren ndërmjet **9 tetorit dhe 20 nëntorit 2023**. Pjesëmarrës në këtë anketë kanë qenë të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë, duke siguruar mbulim të barabartë të zonave urbane dhe rurale.

Qasje cilësore

Pas ndjekjes së të dhënave sasiore, UBO Consulting përfshiu gjithashtu metoda dhe teknika cilësore për mbledhjen e të dhënave për të verifikuar dhe zgjeruar të dhënat. Dizajni i hulumtimit me metoda të përziera janë vendimtare pasi ato lejojnë përgjithësimin nga të dhënat sasiore dhe verifikimin dhe gjerësinë përmes të dhënave cilësore. Përmes diskutimeve në fokus grupe, ekipi ishte në gjendje të kuptonte më mirë përvojat personale të qytetarëve, besimet dhe perceptimet në lidhje me komunat e tyre përkatëse.

Janë organizuar shtatë (7) diskutime në fokus grupe duke përdorur një qasje të mbulimit gjeografik. Kjo do të thotë se gjashtë (6) fokus grupe janë mbajtur nëpër rajonet e Kosovës. Ndërsa një (1) diskutim në fokus grup (DFG) është zhvilluar me komunitetin serb në Graçanicë. Diskutimet u zhvilluan si më poshtë:


1. DFG në Prishtinë – që mbulon rajonin e Prishtinës.
2. DFG në Pejë – që mbulon rajonin e Pejës.
3. DFG në Gjakovë – që mbulon rajonin e Gjakovës.
4. DFG në Prizren – që mbulon rajonin e Prizrenit.

5. DFG në Gjilan – që mbulon rajonin e Gjilanit.
6. DFG në Mitrovicë – që mbulon rajonin e Mitrovicës, duke përjashtuar Mitrovicën e Veriut.
7. DFG në Graçanicë – që mbulon minoritetin etnik serb.

Duhet theksuar se për shkak të faktorëve të jashtëm, disa komuna brenda këtyre rajoneve nuk ishin plotësisht të përfaqësuara, si p.sh. Prishtina. Megjithatë, rajonet e tjera mbuloheshin kryesisht nga komunat më të mëdha si Peja (fshatrat dhe Klina); Gjakova (Junik, Deçan); Prizren (Malishevë, Dragash); Gjilani (fshatrat dhe Vitia); Mitrovicë (fshatrat dhe Vushtrria).

Fokus grupet u zhvilluan gjatë nëntorit 2023. Këto diskutime synonin që të mbledhnin të informacione të thelluara në lidhje me përshtypjet e qytetarëve ndaj punës që kryhet nga komunat e tyre si dhe akterët dhe shërbimet specifike. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me ekipin DEMOS, ekipi hulumtues hartoi një udhëzues me një sërë pyetjesh brenda temave që ishin me interes për vlerësimin.

PERCEPTIMET E QYTETARËVE



Qasja në informacion

Ky seksion i raportit, ndër të tjera, ofron të dhëna cilësore dhe sasiore për nivelet e ndërgjegjësimit dhe perceptimet e të anketuarve në lidhje me vendimet komunale, metodat e komunikimit të përdorura për këto vendime, sfidat që lidhen me gjetjen dhe kuptimin e informacionit të tillë dhe aspektet përkatëse.

Në analizimin e të dhënave në lidhje me nivelin e informacionit në lidhje me vendimet që merr komuna e tyre, ishin të dukshme ndryshimet ndërmjet vitit 2021 dhe 2023. Përqindja e të anketuarve që nuk ishin fare të informuar u rrit nga 21%%në 32%, duke nënkuptuar pakënaqshmëri të mundshme ose mungesë (deficit) transparence. E kundërta, ata që ndjeheshin "Deri diku i informuar" u rritën nga 43%në 53 përqind. Rrjedhimisht, është vërejtur një rënie e konsiderueshme në proporcion me ndjenjën "Shumë i informuar" (28% në 11%) dhe "Plotësisht i informuar" (7% në 3%).

Përqindja e të anketuarve që e konsiderojnë veten "Aspak i informuar" për vendimet komunale, rritet në mënyrë progresive me moshën, duke arritur në 44%në mesin e të anketuarve të moshës 65 vjeç e lart. E kundërta, shumica e të anketuarve në të gjitha grup-moshat e kategorizojnë veten si "Deri diku i informuar", me përqindjen më të lartë (57%) të vërejtur në grup-moshën 18-24 vjeç. Kategoria "Shumë i informuar" ka variacion nga 9%në 14 përqind, ku grup-mosha 25-34 vjeç regjistron përqindjen më të lartë. Individët më të rinj kanë tendencë (priren) ta konsiderojnë veten "Deri diku i informuar", ndërsa grup-moshat më të vjetra tregojnë përqindje të larta në kategorinë "Aspak i informuar". Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se kategoria "Plotësisht i informuar" vazhdimisht regjistron përqindje më të ulët. Të ndara sipas komuniteteve, një përqindje më e lartë e pjesëmarrësve serbë (45%) treguan se ishin të informuar mirë ose plotësisht, në kontrast me të anketuarit shqiptarë (12%) dhe të tjerë (28%).

Sa i përket komunave, të anketuarit nga Shtërpce (73%) dhe Mamushë (63%) kanë treguar nivelet më të ulëta të informacionit për vendimet komunale. E kundërta, të anketuarit nga Leposaviqi (84%) dhe Dragashi (53%) raportuan nivelet më të larta të informacionit, duke u shprehur se janë shumë mirë/plotësisht të informuar.

Të dhënat e mbledhura në të gjitha diskutimet e fokus grupeve treguan se pjesëmarrësit nuk ishin të informuar në lidhje me vendimet e marra nga komunat e tyre përkatëse. Kur janë diskutuar vendimet, gjatë të gjitha diskutimeve, shumica e pjesëmarrësve raportuan se kishin marrë vesh për vendime të caktuara (në lidhje me planifikimin urban, ndërtimin, etj.) vetëm pasi kishte përfunduar puna.

Përveç kësaj, kishte një dualitet midis pjesëmarrësve në lidhje me arsyet e nivelit të tyre të informacionit ose mungesës së tij. Për shembull, shumë pjesëmarrës ia hidhnin fajin komunave për mos-transparencë. Ndërsa më pak pjesëmarrës janë shprehur se qytetarët nuk janë aq të interesuar për të gjetur një informacion të tillë.




Figura 1. Sa jeni të informuar për vendimet që merr komuna juaj?

Të gjeturat nga anketa ilustrojnë se si të anketuarit marrin informacione për vendimet komunale në vitin 2021 dhe 2023. Komunikimi përmes fjalëve të njerëzve mbetet metoda mbizotëruese, duke përjetuar një rritje të lehtë nga 47%%në 49%. Ka gjithashtu rritje të mbështetjes përmes TV/Radio Lokale (44% në 47%) dhe Facebook (39% në 44%). Një përqindje më e lartë e të anketuarëve meshkuj (51%) deklaruan se informohen përmes Facebook në krahasim me të anketuarat femra (43%). E kundërta, nevoja nga ueb-faqja e komunës ka rënë pak nga 29% në 25%, ndërsa komunikimi përmes postës ka rënë nga 8%në 2%. Duke analizuar të dhënat sasiore sipas etnisë, ka një dallim të konsiderueshëm në komunikimin përmes email-it me përqindjen më të lartë mes të anketuarëve serb (19%) dhe më të ulët mes të anketuarëve shqiptarë (2%).

Të ndarë sipas komunave, pothuajse të gjithë të anketuarit nga Malisheva deklaruan se vendimet komunale komunikohen përmes televizionit apo radios lokale (99%) dhe përmes fjalëve të njerëzve (94%). Veçanërisht, përmes fjalëve të njerëzve (fjalë goje) mbetet një metodë e përhapur për shpërndarjen e informacionit rreth vendimeve komunale. Ky trend është i dukshëm edhe në komunat tjera, si në Junik (94%) dhe Deçan (91%), ku shumë të anketuar mbështeten përmes fjalëve të njerëzve (fjalë goje) për të qenë të informuar për vendimet e komunës së tyre. Gjithashtu, 96%e të anketuarve nga Klina raportuan se këto vendime komunikohen përmes Facebook-ut.

Të dhënat cilësore pothuajse plotësisht i plotësojnë përgjigjet e lartpërmendura pasi shumica e pjesëmarrësve shpjeguan se si do të përdorin zakonisht mjete të tilla si mediat televizive dhe mediat sociale për të mbledhur informacion mbi vendimet e komunës. Edhe pse më pak pjesëmarrës përmendën komunikimin përmes fjalëve të njerëzve, ajo ishte ende një përgjigje e përhapur në diskutimet e fokus grupeve për komunat si Juniku dhe Klina. Megjithatë, një numër më i madh i pjesëmarrësve deklaruan se përdorin TV lokale ose grupe/faqe të internetit në Facebook për të mbledhur informacion.

Për të zgjeruar më tej, pjesëmarrësit nga Gjilani vunë në dukje grupin e qytetarëve në Facebook, "Network (Rrjeti) Gjilani si burimin e tyre kryesor të informacionit pasi që ata e konsideronin çdo burim tjetër si të pabesueshëm. Ngjashëm, pjesëmarrësit në Gjakovë e përmendën njëzëri TV Syri si burimin e tyre kryesor të informacionit, edhe pse ata e vlerësuan shumë mirë ueb-faqen e komunës. Rajonet e tjera përmendin më shpesh në ueb-faqen e komunës. Megjithatë, kjo gjithmonë është përmendur si një mjet për të parë hapjet e vendeve të punës dhe njoftimet në vend që të shikohen vendimet e marra nga komuna.

Në Junik, veçanërisht, kënaqshmëria me transparencën e informacionit ishte e lartë pasi një nga pjesëmarrësit raportoi se qytetarët mund t'i ndjekin takimet publike edhe online (në internet) përmes faqes së komunës në Facebook. Këto takime publikohen në kohë reale në mënyrë që qytetarët të komentojnë ose thjesht të jenë në kontakt me atë se çfarë po ndodh.

> ***"Ato [takimet komunale] janë të hapura dhe qytetarët e zakonshëm mund të marrin pjesë duke i ndjekur drejtpërdrejt. Nuk dua të jem subjektiv. Këtu, të gjithë do të flasin si qytetarë. Fuqia e qeverisjes komunale është vendimtare. Në rastet kur merren vendime, ato thirren zyrtarisht. Kemi ueb-faqen zyrtare të komunës, e cila është transparente".***
>
> ***- Junik (Burrë)***




Figura 2. Në çfarë mënyra komunikohen këto vendime?

Më tej, gjetjet krahasojnë vizitat e të anketuarve në online platformat komunale në vitin 2021 dhe 2023. Vizitat në faqen e Komunës në Facebook u ulën pak nga 45%%në 2021, në 41%%në 2023, ndërsa vizitat në ueb-faqen e Komunës ranë ndjeshëm nga 26%, në 16%. E kundërta, kategoria 'Asnjë' u rrit nga 49% në 54%, duke treguar një përqindje në rritje të njerëzve që nuk angazhohen me këto platforma.

Për më tepër, të anketuarit nga Kllokoti (62%) dhe Parteshi (54%) kryesisht kanë qasje në ueb-faqen e komunës në 12 muajt e fundit. Për dallim, një pjesë e rëndësishme e të anketuarve nga Juniku (92%), Deçani (89%), Leposaviqi (89%) dhe Rahoveci (84%) kanë raportuar se kanë vizituar faqen e Komunës në Facebook. Është interesante, se të gjithë të anketuarit nga Shtërpca (100%) deklaruan se nuk kishin vizituar asnjë platformë. Ndonëse jo universale, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve që nuk kanë vizituar asnjërën nga platformat janë vërejtur në Ranillug (86%), Kaçanik (80%) dhe Novobërdë (80%).

Duke analizuar sjelljen e të anketuarve në lidhje me platformat komunale gjatë 12 muajve të fundit, rezultatet zbulojnë modele të ndryshme të angazhimit. Një pjesë e konsiderueshme prej 40% raportuan vizita të rralla, duke theksuar nevojën për të adresuar pengesat (barrierat) për angazhimin e rregullt. Vizitat javore u vunë re me 26% dhe vizitat mujore me 21%, duke theksuar nivele të ndryshme të ndërveprimit të qëndrueshëm. Për më tepër, 13% raportuan vizita ditore, duke treguar një grup më të vogël por aktiv që mbështetet në platformat komunale për qasje të shpeshtë në informacion.




Figura 3. Në 12 muajt e fundit, a keni vizituar ndonjërën si në vijim?

Kur analizohet sipas komunave, shumica e të anketuarve që kanë raportuar se vizitojnë platformat komunale çdo ditë janë nga Juniku (40%). Në të kundërt, të anketuarit nga Podujeva (97%) dhe Gllogovci (67%) kryesisht vizitojnë ueb-faqet e komunave çdo javë. Vizitat mujore janë më të zakonshme në mesin e të anketuarve nga Kllokoti dhe Mitrovica e Veriut (54% në secilën komunë). Veçanërisht, të anketuarit nga Ranillugu raportuan për vizita të rralla në platformat komunale (100%).




Figura 4. Sa shpesh i keni vizituar platformat komunale në 12 muajt e fundit?

Të anketuarit që pohuan angazhimin e tyre me platformat komunale në pyetjen e mëparshme më tej u pyetën për të shtjelluar motivet e tyre. Arsyet kryesore të përmendura për të vizituar faqet në Facebook dhe/ose ueb-faqet e komunës së tyre kanë përfshi hapjet e vendeve të punës (konkurset), që përbëjnë 71%në 2021 dhe 58%në 2023. Kjo u pasua nga subvencionet (38% në 2021 dhe 42% në 2023) dhe informacione në dëgjimet publike (34% në 2021 dhe 30% në 2023). Veçanërisht, ka një rritje të të anketuarve që zgjedhin kategorinë 'Tjetër', duke u rritur nga 2%në 2021, në 13% në 2023. Kur u pyetën për të dhënë më shumë detaje, shumica e të anketuarve (306 nga 394) zbuluan se vizitat e tyre në platformat komunale ishin vetëm për marrjen e informacionit të përgjithshëm për komunën e tyre.

Për më tepër, të gjithë të anketuarit nga Ranillugu treguan se vizitat e tyre në platformat komunale ishin të motivuara vetëm nga subvencionet (100%). Të anketuarit kryesisht zgjodhën dëshirën për të marrë informacion për tenderët publikë nga Kllokoti (58%) dhe Malisheva (54%). Për të anketuarit nga Skenderaji (72%) dhe Mitrovica e Jugut (63%), qëllimi primar i vizitës së platformave ishte mbledhja e informacionit rreth dëgjimeve publike. Në

anën tjetër, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve nga Juniku dhe Deçani (83%), Novobërda (80%), Shtërpca (79%) dhe Podujeva (78%) kanë vizituar ueb-faqet e komunës kryesisht për të kërkuar vende pune.

Përveç kësaj, të dhënat zbulojnë prirje të dallueshme të lidhura me moshën në preferencat e platformës. Veçanërisht, interesi për tenderët publikë arrin në 20% për grup-moshat 55-64 vjeç dhe 19% për ata 65 vjeç e më lart, në kontrast me një interes më të ulët prej 10%te moshat 18-24 vjeç. Dëgjimet publike tërheqin interes të konsiderueshëm në të gjitha grup-moshat, me nivelet më të larta të vërejtura në demografinë 55-64 (39%) dhe 65+ (37%). Personat e rinj, veçanërisht ata të moshës 18-24 (59%) dhe 25-34 (64%), shprehin interes të madh në hapjen e vendeve të punës (konkurse). Subvencionet ruajnë interes relativisht të qëndrueshëm në të gjithë demografinë, ku përqindja më e lartë është 54%në grup-moshën 45-54 vjeç. Interesi për buxhetin dhe shpenzimet komunale rritet me moshën, duke arritur kulmin në 47% për grup-moshën 65+, ndërsa grup-mosha 18-24 vjeç shfaq interesin më të ulët në 15 përqind.

Në ngjashmëri, të dhënat shpalosin trende specifike në baza etnie në platformat e preferuara. Specifikisht, interes më i lartë vihet re në informacione rreth tendereve publike në komunitetet e Tjera deri në 25%, përkundrazi niveleve më të ulëta të interesit mes serbëve (8%) dhe shqiptarëve (14%). Në anën tjetër, dëgjimet publike tërheqin interes të konsiderueshëm me shtrirje në të gjitha etnitë me nivelet më të larta të vura re mes të tjerëve me 52% në krahasim me 24%të serbëve dhe 29%%të shqiptarëve. Në lidhje me hapjet e vendeve të punës, të gjeturat tregojnë se shqiptarët shfaqin interes më të lartë me 59%, duke u pasuar nga serbët me 48%dhe të tjerët me 44%. Interesi në buxhetin komunal dhe shpenzimet komunale paraqet dallime bazuar në etni përderisa shqiptarët shfaqin interesin më të lartë me 23%, pasuar nga serbët me 16% dhe të tjerët 14%.

Të anketuarit meshkuj zakonisht i përdorin platformat komunale për qëllime të ndryshme me përqindjet më të larta nëqasjen ndaj informacioneve në lidhje me tenderët publik (17%), subvencionet (46%) dhe buxhetin dhe shpenzimet komunale (25%). Përkundrazi, të anketuarat gra demonstrojnë një interes më të lartë në hapjet e vendeve të punës (63%), ndërsa përqindjet e tyre në kategori të tjera siç janë tenderët publik (10%), subvencionet (37%) dhe buxheti dhe shpenzimet komunale (18%) janë më të ulëta në krahasim. Të dy gjinitë shprehin thuajse interes të barabartë në informacionet në lidhje me dëgjimet publike (31% për burrat dhe 29% për gratë).




Figura 5. Për çfarë arsye?

Nga ana tjetër, studimi po ashtu hulumtoi pse të anketuarit nuk i kanë vizituar platformat komunale në 12 muajt e fundit, duke hedhur dritë mbi faktorët që ndikojnë në mos-angazhim. Arsyeja më e përhapur, e cituar nga 51% e të anketuarve, është mungesa e interesit për përditësimet komunale. Kjo sugjeron që një pjesë e konsiderueshme e popullsisë mund të mos e gjejë përmbajtjen në këto platforma mjaft bindëse ose të rëndësishme për të garantuar vizita të rregullta. Në një kontekst më specifik, të dhënat tregojnë se të anketuarit që deklaruan mungesë interesi për përditësimet komunale vijnë nga Podujeva (94%), Dragashi (84%), Vushtrria (80%), Shtërpca (79 %), dhe Ferizaji (78%). Për më tepër, 22% e tjerë përmendën mungesën e vetëdijes për ekzistencën e këtyre platformave si arsye të mos-angazhimit. Kjo ishte më mbizotëruese në Zveçan (77%) dhe Novobërdë (58%). Kjo gjetje nënvizon një sfidë komunikimi për komunat në promovimin efektiv dhe ndërgjegjësimin e banorëve për burimet dixhitale në dispozicion. Preferenca për marrjen e informacionit nga burime alternative u shprehën nga 19%e të anketuarve, ndërsa një përqindje më e vogël, shtatë për qind, i shohin platformat të vështira për t'u përdorur (naviguar). Sa i përket komunave, shumica e të anketuarve që preferojnë të marrin informacion nga burime të tjera janë nga Deçani (79%) dhe Malisheva (78%).




Figura 6. Pse nuk keni vizituar asnjë nga platformat komunale?

Në përputhje me prirjet (tendencat) e vërejtura në vitin 2021, më shumë të anketuar kanë konfirmuar gjetjen me sukses të informacionit ose shërbimit të kërkuar gjatë vizitës në platformat komunale. Për të qenë të saktë, 76% e pohuan këtë në vitin 2021, dhe një përqindje paksa e reduktuar me 74%, por ende e konsiderueshme, e pohuan këtë në vitin 2023, me të anketuarit e mbetur që shprehën kundërshtimin ndaj kësaj përvoje. Komunat ku një përqindje e dukshme e të anketuarve kanë raportuar vështirësi në këtë drejtim përfshijnë Shtërpcë (69%), Zveçan (61%), Graçanicë (58%), Zubin Potok (57%), Novobërdë (56%), Ferizaj (54%) dhe Mitrovica e Veriut (53%).




Figura 7. A e keni gjetur informacionin/shërbimin e kërkuar?

Për më tepër, të anketuarit vazhdimisht e shohin më të përshtatshëm për të gjetur informacionet që u nevojitet në faqen e komunës në Facebook sesa në ueb-faqen e komunës. Siç përshkruhet në tabelën e dhënë, shumica e të anketuarve raportuan se kishin gjetur informacionin e kërkuar ose "Lehtë" ose "Shumë lehtë" në të dyja platformat. Konkretisht, për ueb-faqen e komunës në vitin 2021, 77% e të anketuarve e kanë pasur lehtë ose shumë lehtë; në vitin 2023, kjo përqindje u rrit në 96%. Në faqen e Facebook-ut, 84% e të anketuarve në vitin 2021 dhe 96% në vitin 2023 raportuan se e gjenin informacionin lehtë ose shumë lehtë. Ky model nënvizon një nivel më të lartë të kënaqshmërisë dhe lehtësinë e perceptuar të qasjes kur përdorin ueb-faqen e komunës në Facebook në vend të ueb-faqes së saj zyrtare.




Figura 8. Sa lehtë e keni gjetur informacionin që ju nevojitej?

Të dhënat pasqyrojnë perceptimet e të anketuarve për lehtësinë me të cilën ata e kuptuan informacionin e publikuar nga komuna në 2021 dhe 2023. Shumica e të anketuarve në të dy vitet raportuan se e kishin gjetur informacionin të kuptueshëm, me ndryshime të dukshme në shpërndarje. Në vitin 2021, 28% e të anketuarve treguan se informacioni ishte shumë i kuptueshëm, ndërsa 55%e gjetën atë deri diku të kuptueshëm. Megjithatë, në vitin 2023, pati një rritje të konsiderueshme të të anketuarve që e gjenin informacionin shumë të kuptueshëm, duke u rritur në 52%, dhe një rënie korresponduese në ata që e shihnin atë deri diku të kuptueshëm, duke rënë në 44% – një ndryshim që sugjeron një përmirësim në qartësinë dhe kuptueshmërinë të informacionit të publikuar nga komuna. Rrjedhimisht, përqindja e të anketuarve që e gjetën informacionin deri diku të pakuptueshëm është ulur nga 14% në 2021, në 5% në 2023, duke treguar një prirje pozitive të shtuar në qartësim.




Figura 9. Sa i kuptueshëm ka qenë informacioni i publikuar nga komuna që e keni gjetur?

Për më tepër, vlen të përmendet se të anketuarit nga komunat e veçanta, duke përfshirë Graçanicën (100%), Ranillugun (100%), Malishevën (100%), Suharekën (100%), Klinën (100%), Shtimen (100%) dhe Prishtinën (100%), në mënyrë universale raportuan se informacioni i publikuar nga komuna ishte deri diku/shumë i kuptueshëm. E kundërta, në Novobërdë, 58%e të anketuarve kanë gjetur se informacioni është deri diku i pakuptueshëm, që paraqet përqindjen më të lartë në këtë kategori në mesin e të gjitha komunave të anketuara.

Për më tepër, disa pjesëmarrës të moshuar nga diskutimet e fokus grupeve shprehën vështirësi për të kuptuar ueb-faqen ose zhargonin e përdorur. Përveç Klinës dhe Junikut, shumë pjesëmarrës i konsideruan ueb-faqet si jo të besueshme. Ata shtjelluan duke thënë se informacioni i publikuar nuk është transparent dhe publikohet vetëm për formalitete. Për këtë arsye, qytetarët janë më të prirë për të marrë informacion përmes mjeteve të tjera.

Pjesëmarrja qytetare (angazhimi)

Ky seksion (pjesë) i raportit analizon se si angazhohen qytetarët e Kosovës me komunat e tyre përkatëse. Brenda këtij segmenti, lexuesit do të fitojnë njohuri për shkallën e pjesëmarrjes së të anketuarve në takimet publike, natyrën e shqetësimeve të shprehura nga qytetarët, nivelin e kënaqshmërisë së tyre me përgjigjet komunale dhe informacionin përkatës për buxhetin komunal.

Të dhënat më tej theksojnë ndërveprimet e të anketuarve me komunën e tyre në 12 muajt e fundit, duke përjashtuar periudhat e fushatës zgjedhore, duke krahasuar rezultatet nga viti 2021 në 2023. Gjetjet zbulojnë ndryshime të dukshme në modelet e angazhimit. Pjesëmarrja në takimet publike, duke përfshirë dëgjimet publike dhe takimet me kryetarin, janë ulur ndjeshëm nga 16%në vitin 2021 në 5% në vitin 2023. Nga ana tjetër, takimet individuale që përfshinin ndërveprime me kryetarin, drejtorin ose anëtarët e kuvendit komunal janë ulur nga 13%në 2021, në shtatë për qind në 2023. Angazhimi përmes nismave të përbashkëta të komunitetit, si këshillat e fshatit/lagjes dhe Organizatat e Shoqërisë Civile, janë ulur gjithashtu nga 12% në 2021, në 5% në 2023. Kjo rënie sugjeron ulje të pjesëmarrjes në përpjekjet bashkëpunuese të komunitetit. Si rezultat, shumica e të anketuarve, 74% në vitin 2021 dhe një rritje prej 86% në vitin 2023, raportuan se nuk kishin asnjë ndërveprim me komunën e tyre në periudhën e specifikuar. Duke i zbërthyer rezultatet e anketës sipas gjinisë, vërehet se më shumë femra (93%) sesa meshkuj (80%) nuk kanë ndërvepruar me komunën e tyre në 12 muajt e fundit. Më tutje, 88% e të anketuarëve shqiptarë dhe 80% e atyre të kategorizuar si të tjerë tregojnë ndërveprim të ulët me komunën e tyre. Në krahasim, 44% e të anketuarëve serb raportuan se nuk kanë ndërvepruar me komunën e tyre. Kjo rritje e konsiderueshme nënkupton një segment në rritje të popullsisë me angazhim ose përfshirje të kufizuar në çështjet komunale.

Sipas gjetjeve të anketës, individët nga Podujeva (100%) dhe Graçanica (100%) raportuan se nuk kanë pasur ndërveprim me komunën e tyre gjatë 12 muajve të fundit. Veçanërisht, takimet publike kanë pa pjesëmarrje më të madhe në Kllokot (38%) dhe Dragash (30%) në krahasim me komunat tjera. Banorët e Kllokotit ishin gjithashtu të përfshirë dukshëm në iniciativat e përbashkëta të komunitetit, me 62% pjesëmarrje. Vlen të theksohet se tre komunat kryesore me përfshirjen më të madhe të të anketuarve në iniciativat e përbashkëta të komuniteteve janë zonat me shumicë serbe, duke përfshirë Kllokotin (62%), Leposaviqin (49%) dhe Parteshin (34%).

Gjatë diskutimeve në fokus grupe, pjesëmarrësit nga Gjilani, Klina, Juniku dhe Dragashi kanë raportuar se kanë marrë pjesë. Megjithatë, pjesa tjetër e pjesëmarrësve nuk ishin në dijeni për takimet publike në komunat e tyre. Ata ia ndanë këtë përgjegjësi udhëheqësit të lagjes/fshatit për t'i informuar. Sipas tyre, udhëheqësit e lagjeve/fshatit nuk i informojnë qytetarët e tjerë të grupit të tyre për takimet publike apo diskutimet që mund të marrin pjesë në interes të qytetarëve.

Kur u pyetën më tej se pse nuk ndërveprojnë me komunat e tyre, shumica e tyre thanë se janë të vetëdijshëm për vendimet e marra nga komunat pas marrjes së tyre. Një grup tjetër i pjesëmarrësve gjithashtu informoi këtë vlerësim se ata kishin marrë pjesë më parë në takime publike ose individuale. Megjithatë, për shkak të zhgënjimit që kishin hasur në mungesën e konsideratës për sugjerimet e tyre, ata ishin tërhequr plotësisht nga pjesëmarrja. Sipas tyre, kjo ka ndikuar në uljen e nivelit të interesimit të tyre për çështjet komunale.




Figura 10. Si keni ndërvepruar me komunën tuaj në 12 muajt e fundit (përveç gjatë fushatës elektorale)?

Të anketuarit që konfirmuan angazhimin me komunën e tyre përmes takimeve individuale më pas u pyetën nëse ata ngritën çështje specifike gjatë këtyre takimeve. Bazuar në gjetjet, gjysma e të anketuarve (54%) pranuan se ngritën shqetësime, ndërsa pjesa tjetër 46% treguan se nuk ngritën ndonjë çështje specifike gjatë këtyre takimeve. Veçanërisht, pjesëmarrësit nga Deçani (100%), Rahoveci (100%) dhe Novobërda (100%) raportuan se kishin ngritur shqetësime specifike gjatë takimeve. E kundërta, të anketuarit nga Ranillugu (100%) dhe Graçanica (89%) kanë theksuar mungesën e ngritjes së çështjeve specifike gjatë këtyre seancave.




Figura 11. A keni ngritur ndonjë çështje specifike gjatë këtyre takimeve individuale? (n=467)

Po ashtu, në mesin e të anketuarve që konfirmuan përfshirjen në nismat (iniciativat) e përbashkëta të komunitetit (5%) u pyetën nëse ata ngritën çështje specifike gjatë këtyre përpjekjeve. Të dhënat tregojnë një trend të dukshëm, ku shumica e të anketuarve pohojnë se kanë ngritur shqetësime (64%), ndërsa 36% kanë treguar të kundërtën. Njëkohësisht, të gjithë të anketuarit nga Ranillugu (100%) dhe shumica nga Graçanica (97%) nuk ngritën çështje specifike gjatë takimeve. Në të kundërt, pjesëmarrësit nga Deçani (100%), Rahoveci (100%) dhe Novobërda (100%) raportuan se kishin ngritur shqetësime.

Në vitin 2021 dhe 2023, të anketuarit ngritën çështje të ndryshme me komunën, duke zbuluar tendenca të dukshme. Shqetësimet e infrastrukturës lokale, si rrugët, trotuaret dhe ndriçimi, mbetën prioritet, duke u rritur nga 53%, në 65%. E kundërta, çështjet mjedisore kanë rënë nga 47%, në 20%, duke treguar potencialisht përmirësime të perceptuara. Shqetësimet lidhur me arsimin dhe shëndetin janë ulur nga 45% në 19%, dhe respektivisht 35% në 18%. Çështjet e sigurisë publike u ulën nga 34% në 17%, duke sugjeruar përmirësime të mundshme. Aktivitetet kulturore dhe rekreative kanë rënë nga 24% në 8% dhe çështjet e trafikut u ulën nga 23% në 11%. Së fundi, shqetësimet për çështjet që prekin grupet e mar-




Figura 12. A keni ngritur ndonjë çështje specifike gjatë këtyre nismave të përbashkëta të komunitetit? (n=360)

gjinalizuara u ulën nga 15% në 3%, duke reflektuar ndryshimin e prioriteteve dhe perceptimeve të komunitetit gjatë dy viteve.

Rezultatet e anketës tregojnë një përqindje të ulët të përgjithshme (3%) të të anketuarve, pavarësisht nga gjinia, që ngrenë çështje që lidhen me gratë dhe grupet e tjera të margjinalizuara. Veçanërisht, gratë janë më të prirë se burrat për të trajtuar shqetësimet mjedisore, arsimore dhe shëndetësore. Në të kundërt, më shumë burra (71%) raportojnë se kanë ngritur çështje në lidhje me infrastrukturën lokale, ndërsa një përqindje më e ulët e grave (46%) e kanë bërë këtë. Të ndara sipas grupeve etnike, të dhënat nxjerrin në pah se individët nga komuniteti shqiptar dhe komunitetet tjera shprehnin kryesisht shqetësime lidhur me infrastrukturën lokale, me përqindje prej 72% dhe respektivisht 52%. Në të kundërt, një përqindje më e lartë e të anketuarve serbë, që përbëjnë 54% përqind, ngritën çështje mjedisore. Nga ana komunale, ka një model të dallueshëm në çështjet e ngritura nga të anketuarit. Të gjithë pjesëmarrësit nga Gjakova (100%), Gjilani (100%), Gllogovc (100%), Shtime (100%) dhe Shtërpca (100%) shprehën shqetësime për infrastrukturën lokale. Në Novobërdë, të anketuarit kryesisht ngritën çështje të lidhura me arsimin (100%). E kundërta, një pjesë e dukshme e të anketuarve nga Ranillugu (68%) dhe Kaçaniku (66%) adresuan shqetësimet mjedisore gjatë ndërveprimeve.




Figura 13. Çfarë çështjesh keni ngritur në komunë?

Anketa nënvizon reagimin e komunës ndaj çështjeve të ngritura nga të anketuarit në vitin 2021 dhe 2023. Gjetjet tregojnë një rritje të konsiderueshme të të anketuarve që raportojnë se komuna iu përgjigj çështjeve të tyre të ngritura. Në vitin 2021, vetëm 17% e të anketuarve deklaruan se komuna iu përgjigj çështjeve të ngritura. Megjithatë, në vitin 2023, kjo shifër pësoi një rritje të në 56%. Analizimi i përgjigjeve nga komunat nxjerr në pah modele të veçanta në reagimin e autoriteteve lokale. Komunat si Prizreni (100%), Gjilani (100%) dhe Shtërpca (100%) shquhen për shkallën e lartë të përgjigjeve nga komuna. Në anën tjetër, të gjithë pjesëmarrësit nga Zubin Potoku (100%), Graçanica (100%) dhe Novobërda (100%) raportuan se përkundër çështjeve të ngritura, komunat e tyre përkatëse nuk janë përgjigj.

Përveç rritjes së përgjigjeve të vërejtur, anketa ofron informacion për numrin mesatar të ditëve që iu deshën komunës për t›iu përgjigjur çështjeve të ngritura nga të anketuarit. Në vitin 2021, numri mesatar i ditëve që komuna të përgjigjej ishte 16.8 në 2023, kjo është rritur pak në 17.3 ditë. Përderisa diferenca në kohën mesatare të përgjigjes është margjinale, ajo tregon se, mesatarisht, të anketuarit përjetuan një kornizë kohore relativisht të qëndrueshme për përgjigjet e komunës gjatë dy viteve. Ky informacion ofron kontekstin e rritjes së përgjigjeve të vërejtur më parë, duke sugjeruar që pavarësisht nga një prirje e lehtë në kohën mesatare të përgjigjes, komuna vazhdoi të adresojë çështjet e ngritura brenda një afati të arsyeshëm kohor.




Figura 14. Pasi që ngritët një çështje (nga pyetja 8a), a iu përgjigj komuna çështjes që ngritët?

Në vitin 2021, 60% e të anketuarve u shprehën të kënaqur me përgjigjen e komunës, ku 12%deklaruan se ishin plotësisht të kënaqur dhe 49% thanë se ishin deri diku të kënaqur. Po kështu, në vitin 2023, 69% e të anketuarve raportuan të kënaqur. Përqindja e të anketuarve të kënaqur u rrit lehtësisht në 17%, dhe atyre deri diku të kënaqur u rrit në 52%. E kundërta, nivelet e pakënaqshmërisë treguan një rritje minimale, me 28%të të anketuarve në 2021 dhe 30% në 2023 që shprehën pakënaqshmëri.

Në mesin e të anketuarve që ngritën shqetësime gjatë takimeve, ata që shprehën kënaqshmërinë me përgjigjen e komunës ishin kryesisht nga Gllogovci (Drenasi) (100%), Prizreni (100%), Shtërpca (100%) dhe Skenderaji (88%). Në të kundërt, pakënaqshmëria me përgjigjen ishte dukshëm më e lartë në mesin e të anketuarve nga Lipjani (81%), të ndjekur prej atyre nga Vitia (60%), Zubin Potoku (55%) dhe Kamenica (51%).




Figura 15. Sa keni qenë të kënaqur me reagimin e komunës për çështjen që ngritët?

Të anketuarit të cilët shprehën pakënaqshmëri me përgjigjen e komunës për çështjet e ngritura u kërkua më tej të specifikojnë arsyet e pakënaqshmërisë së tyre. Arsyeja më e përmendur për pakënaqshmëri ishte mungesa e vazhdimësisë ose mbështetjes së vazhdueshme nga komuna, me 39%të të anketuarve që shprehën këtë shqetësim. Kjo tregon një pjesë të konsiderueshme të individëve të cilët mendonin se angazhimi i komunës përfundoi para kohe ose i mungonte përfshirja e qëndrueshme në adresimin e çështjeve të ngritura. Një tjetër arsye e dukshme për pakënaqshmëri, e raportuar nga 24% e të anketuarve, ishte se veprimet e ndërmarra nga komuna u konsideruan të pamjaftueshme për të adresuar çështjet e ngritura në mënyrë adekuate. Pothuajse e njëjta përqindje, 22% , tregoi se përgjigja zgjati shumë dhe çështja mbeti e pazgjidhur. Përveç kësaj, 12% e të anketuarve cituan pakënaqshmëri nga mungesa e perceptuar e komunës së komunikimit efektiv ose ofrimit të informacionit të qartë.

Sa i përket komunave, të anketuarit nga Fushë Kosova (100%), Zveçani (100%), Malisheva (100%), Graçanica (100%) dhe Obiliqi (100%) kanë raportuar pakënaqshmëri për shkak se nuk kishte asnjë vazhdim apo mbështetje të vazhdueshme nga komuna. Në anën tjetër, të anketuarit nga Zubin Potoku (100%), Istogu (67%) dhe Juniku (67%) kanë treguar se përgjigja ka zgjatur shumë dhe çështja ka mbetur e pazgjidhur. Pakënaqshmëri për shkak të komunikimit joefektiv apo informatave të paqarta u shprehën nga të anketuarit nga Gjilani (100%), Mamusha (100%) dhe Novobërda (100%). Përveç kësaj, të anketuarit nga Prishtina (67%), Leposaviqi (60%) dhe Dragashi (56%) deklaruan se ishin të pakënaqur sepse veprimet e ndërmarra nga komuna ishin të pamjaftueshme për të adresuar këtë çështje.




Figura 16. Pse nuk ishit të kënaqur me përgjigjen e komunës?

Ekzaminimi i perceptimeve të të anketuarve për angazhimin e komunës gjatë takimeve publike në 2021 dhe 2023 zbulon ndryshime të dukshme në llojet e ndërveprimit të raportuar. Në vitin 2021, shumica e të anketuarve (58%) ndiheshin të informuar kryesisht për ngjarjet e kaluara ose të ardhshme gjatë takimeve publike. Megjithatë, në vitin 2023, pati një rënie të ndjeshme të këtij perceptimi, me vetëm 29% që raportuan komunikim të njëanshëm. E kundërta, përqindja e të anketuarve që mendonin se komuna ofronte opsione të ndryshme dhe kërkuan komente/ofrimi i mendimeve u rrit nga 32% në 2021, në 51%n ë 2023. Kjo sugjeron një zhvendosje thelbësore drejt një angazhimi më interaktiv, ku komuna kërkon në mënyrë aktive të dhëna nga pjesëmarrësit. Për më tepër, të anketuarit që mendonin se komuna inkurajonte komente/ofrimi i mendimeve të hapura (pa prezantuar opsione) u rritën nga 10% në 2021, në 20% në 2023.

Duke analizuar metodat e komunikimit, është evidente se komuna e Novobërdës (100%) dhe Shtërpcës (100%) kryesisht i informojnë qytetarët për ngjarjet dhe zhvillimet. Komunat që shpesh kërkojnë komente dhe ofrim të mendimeve përmes opsioneve të ndryshme janë Peja (100%) dhe Istogu (80%). Në të kundërt, kërkesa për komente të hapura pa opsione të paracaktuara është më e përhapura në Gjakovë, ku 52%e të anketuarve kanë raportuar se e kanë përjetuar këtë qasje.




Figura 17. Si ju përfshin komuna gjatë takimeve publike?

Për më tepër, të anketuarit u pyetën se deri në çfarë mase autoritetet komunale i morën parasysh sugjerimet e pjesëmarrësve gjatë takimeve publike në vitin 2021 dhe 2023. Gjetjet tregojnë ndryshime në nivelet e marrëveshjes gjatë dy viteve. Më konkretisht, në vitin 2021, 75% e të anketuarve pajtohen (48%) ose janë plotësisht pajtohen (26%) që autoritetet komunale të marrin parasysh sugjerimet e pjesëmarrësve gjatë takimeve publike. Megjithatë, në vitin 2023, ky perceptim pësoi një rritje të dukshme, me 84%të të anketuarve që pajtohen (60%) ose plotësisht pajtohen (24%). E kundërta, përqindja e të anketuarve që nuk pajtohen (21%) ose plotësisht nuk pajtohen (3%) në vitin 2021, është ulur në 16%të kombinuar në vitin 2023.

Kur analizohet sipas përkatësisë etnike, vërehet se një përqindje më e madhe e të anketuarve Serbë pajtohen/plotësisht pajtohen që autoritetet komunale i marrin parasysh sugjerimet e pjesëmarrësve gjatë takimeve publike (45%), krahasuar me shqiptarët (9%) dhe të anketuarit e tjerë (10%). Për më tepër, të gjeturat tregojnë se personat 65 vjeç apo më lartë shfaqën nivel më të lartë të optimizmit (90%) sa i përket konsideratës ndaj sugjerimeve për autoritetet komunale gjatë dëgjimeve publike. Përkundrazi, përqindja më e ulët shihet tek të rinjtë, specifikisht për grupmoshën 18-24 teksa 75% shprehin sentimet të ngjashëm. Përqindje më e lartë e të anketuarëve meshkuj (86%) shprehën pajtim ose pajtim të plotë në krahasim me 78% të të anketuarave gra.

Duke shqyrtuar perspektivat nëse autoritetet komunale i marrin parasysh sugjerimet e pjesëmarrësve gjatë takimeve publike, të anketuarit nga Novobërda (94%) dhe Vitia (62%) shprehen nuk pajtohem ose plotësisht nuk pajtohem me këtë nocion. Në të kundërt, plotësisht pajtohem për këtë çështje raportohet nga të anketuarit nga Prishtina, Mitrovica e Jugut, Prizreni, Zubin Potoku, Juniku, Mamusha, Kamenica dhe Gjilani.

Në një farë kontradikte, kjo ishte një nga pikat kryesore të shumicës së fokus grupeve. Kur pjesëmarrësit u pyetën për këtë, pothuajse të gjithë qytetarët pjesëmarrës u pajtuan njëzëri se sugjerimet e qytetarëve nuk merren parasysh. Disa madje kryesisht në mënyrë sarkastike u përgjigjën me po, për të zbuluar më vonë se pajtohen me shumicën që u tha këtu. Ata që ishin më të predispozuar për t'iu përgjigjur në mënyrë sarkastike kësaj pyetjeje i transformuan më tej përgjigjet e tyre duke përshkruar se si sugjerimet 'dëgjohen dhe konsiderohen' shumë, gjatë zgjedhjeve. Megjithatë, kjo nuk ndodhë një herë kur marrin mandatin. Ky besim ishte mbizotërues në fokus grupe pasi që pjesëmarrësit treguan situatat e tyre individuale ku nuk ishin marrë parasysh nga komunat. Për shembull, shumë pjesëmarrës kishin vërejtje sa i përket procedurave të gjata të ankesave, sipas së cilave ata ishin ankuar dhe nuk kishin dëgjuar nga komunat e tyre. Disa prej ankesave të raportuara kishin një apo dy vjet pa u validuar, sipas pjesëmarrësve.




Figura 18. Deri në çfarë mase pajtoheni që autoritetet komunale marrin parasysh sugjerimet e pjesëmarrësve gjatë takimeve publike?

Për më tepër, studimi vlerëson gatishmërinë e të anketuarve për t'u angazhuar me komunën e tyre duke përdorur platforma dixhitale, duke krahasuar përgjigjet nga viti 2021 deri në vitin 2023. Në vitin 2021, 62% e të anketuarve shprehën gatishmëri për të përdorur platforma dixhitale, e cila është rrit pak, me dy pikë përqindje - në 64%në vitin 2023. E kundërta, përqindja e të anketuarve që nuk dëshirojnë të përdorin platforma dixhitale është ulur nga 38% në 2021, në 36% në 2023, duke treguar një reduktim të vogël të rezistencës ose skepticizmit ndaj miratimit të kanaleve dixhitale për angazhimin komunal. Të dhënat kolektive nënvizojnë një hapje të vazhdueshme midis të anketuarve për të përqafuar platformat dixhitale për ndërveprim me komunën e tyre.

Dallime të konsiderueshme u evidentuan në bazë të grupmoshës sa i përket vullnetit të të anketuarëve për përdorimin e platformave digjitale për angazhim komunal. Dukshëm, 78%e grupmoshës 25-34 shprehën një prirje të fortë në krahasim me 34% të grupmoshës 65 e më lartë. Të dhënat e ndara sipas gjinisë zbulojnë një dallim 10%. Për të specifikuar, 69% e të anketuarëve meshkuj shprehën vullnet për të ndërvepruar me platformat digjitale në krahasim me 59% të të anketuarave femra që ndajnë të njëjtin vullnet.

Duke analizuar të dhënat, është evidente se të anketuarit nga Ferizaji (87%), Juniku (85%), Kllokoti (84%), Prishtina (81%), Rahoveci (80%), dhe Istogu (80%) shprehin një gatishmëri më të madhe për të përdorur platformat digjitale për angazhim me komunat e tyre. Në të kundërt, të anketuarit nga Mitrovica e Veriut (78%), Novobërda (71%), Mamusha (66%), Shtërpca (66%), Podujeva (64%), dhe Leposaviqi (63%) janë më pak të prirë për ta bërë këtë.




Figura 19. A do të ishit të gatshëm të përdorni platformat dixhitale për të komunikuar/ndërvepruar me komunën tuaj?

Sa i përket vetëdijes së të anketuarve për ndarjen e buxhetit komunal, 23% e të anketuarve në vitin 2021, kanë pohuar se kanë informacion për ndarjen e buxhetit komunal, ndërsa deri në vitin 2023 kjo shifër është ulur në 17%. Njëkohësisht, përqindja e të anketuarve që deklarojnë se nuk posedojnë informacione të tilla është rritur nga 77% në vitin 2021, në 83%në vitin 2023. Të dhënat tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve nga Leposaviqi (58%) pretenduan se kishin informacion se si ndahet buxheti komunal. Megjithatë, të anketuarit nga komunat e tjera, veçanërisht nga Zubin Potoku (100%), Ranillugu (100%) dhe Shtërpca (100%), raportuan se kishin mungesë të informacionit në lidhje me ndarjen e buxhetit komunal. Kjo rënie në përqindjen e individëve me njohuri për ndarjen e buxhetit komunal sugjeron një rënie të mundshme në angazhimin publik ose përpjekjet e komunikimit në lidhje me transparencën buxhetore. Rritja e të anketuarve pa informacion mund të tregojë nevojën për strategji të zgjeruara për të edukuar dhe informuar publikun për mënyrën se si ndahen buxhetet komunale.




Figura 20. A keni informacion se si ndahet buxheti komunal?

Për më tepër, të gjeturat mbi kënaqshmërinë me përcaktimin e prioriteteve të projektit në buxhetin komunal, të mbledhura në vitin 2021 dhe 2023, tregojnë një trend të përgjithshëm pozitiv. Shumica e të anketuarve u shprehën të kënaqur, me një rritje të dukshme nga 56%në 64%në kategorinë "Deri diku i kënaqur». Ndërsa kishte luhatje të vogla, si një rënie e lehtë e të anketuarve plotësisht i kënaqur (21% në 18%) dhe një rritje e vogël e atyre që janë plotësisht të pakënaqur (3% në 4%), këto ndryshime janë relativisht modeste - veçanërisht

duke pasur parasysh se shumica e të anketuarve raportuan se nuk ishin në dijeni për ndarjen e buxhetit brenda komunave të tyre përkatëse. Të dhënat tregojnë se një përqindje më e lartë e të anketuarve meshkuj (84%) janë shprehur të kënaqur se sa të anketuarit femra, prej të cilëve 78%kanë treguar kënaqshmëri. Gjatë ekzaminimit të niveleve të kënaqshmërisë sipas komunave, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve në të gjitha komunat raportuan se janë të kënaqur me përcaktimin e prioriteteve të projektit në buxhetin komunal. Përjashtim bën vetëm komuna e Graçanicës, ku të gjithë të anketuarit janë shprehur deri diku/plotësisht i pakënaqur (100%).




Figura 21. Sa jeni të kënaqur me përcaktimin e prioriteteve në kuadër të buxhetit komunal?

Roli i Kuvendit Komunal

Ky seksion i raportit është krijuar për të ofruar njohuri mbi vetëdijen dhe perspektivat e qytetarëve Kosovarë në lidhje me Kuvendin Komunal. Ai synon të hulumtojë (eksplorojë) nivelin e tyre të përfshirjes në seancat e Kuvendit Komunal dhe të hedhë dritë mbi arsyet themelore që nxisin pjesëmarrjen e tyre në këto diskutime.

Kur u pyetën për shkallën në të cilën të anketuarit janë të vetëdijshëm për rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Kuvendit komunal, dhjetë%e të anketuarve në vitin 2021 pretenduan se nuk ishin në dijeni. Megjithatë, deri në vitin 2023, kjo përqindje u dyfishua në 26 përqind, duke treguar një rënie të dukshme të ndërgjegjësimit. Kategoria e të anketuarve që raportuan se ishin pak të vetëdijshëm mbeti relativisht e qëndrueshme, me 31% në 2021, dhe 34% në vitin 2023. Në të kundërt, ata që e konsideronin veten mesatarisht të vetëdijshëm u ulën nga 41%në 2021, në 29% në 2023, duke nënkuptuar një rënie të konsiderueshme në këtë kategori. Përfundimisht, përqindja më e ulët vlen për të anketuarit që e konsiderojnë veten jashtëzakonisht të vetëdijshëm, me 9%.

Në mesin e të anketuarve, ata në Klinë (87%) treguan vetëdijen më të lartë për rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të tyre të kuvendit komunal, përcjellë nga Dragashi (75%) dhe Juniku (72%). Në të kundërt, 94%e anketuesve pjesëmarrës në Shtërpcë shprehën mungesë të vetëdijes për rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të kuvendit komunal (asambleistëve).

Gjatë diskutimit në fokus grupe, pjesëmarrësit nga Gjilani, Prishtina dhe Mitrovica ishin më të informuar për përgjegjësitë e anëtareve të kuvendit (asambleistëve). Në të njëjtën kohë, pjesëmarrësit nga rajonet e tjera ishin disi të informuar për përgjegjësitë e kuvendit komunal. Në përgjithësi, të gjithë njëzëri u pajtuan se detyra kryesore e çdo anëtari të kuvendit (asambleisti) është të përfaqësojë mendimet e qytetarëve të cilët i përfaqësojnë në varësi të lagjeve apo fshatrave që mbulojnë.




Figura 22. Sa jeni të vetëdijshëm për rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të kuvendit komunal?

Në vitin 2021, 29%e të anketuarve kanë raportuar se janë takuar me anëtarët e kuvendit komunal, ndërsa 71%kanë treguar se nuk kanë pasur një ndërveprim të tillë. Në të njëjtën kohë, deri në vitin 2023, përqindja e të anketuarve që janë takuar me ndonjë anëtar të kuvendit komunal është ulur ndjeshëm në 16%, dhe përqindja e atyre që nuk janë takuar është rritur në 84%. Kur zbërthehen rezultatet e studimit sipas gjinisë, tregon se më shumë meshkuj (22%) sesa femra (9%) janë takuar me ndonjë anëtar të Kuvendit Komunal. Në Kllokot, 82% e të anketuarve kanë raportuar se janë takuar me anëtarët e kuvendit komunal në 12 muajt e fundit për të diskutuar çështje të përbashkëta publike. Ky ndërveprim (angazhim)

ishte i dukshëm edhe në Rahovec (43%), Junik (42%) dhe Leposaviq (41%). Ndryshe, asnjë i anketuar nga Shtërpca nuk raportoi për takime të tilla. Ky model është ndjekur nga 99% e të anketuarve në Zubin Potok, 98% në Novobërdë dhe Podujevë, 96% në Gjilan, 95% në Graçanicë, e kështu me radhë.

Në një numër të konsiderueshëm pjesëmarrësish nga diskutimet e fokus grupeve gjithashtu vunë re se ata as nuk e dinë se cilët janë anëtarët e kuvendit (asambleistët) e tyre të zgjedhur. Në vend të kësaj, ata filluan të japin sugjerime për mënyra më të mira për të komunikuar me ta. Disa sugjeruan që anëtarët e kuvendit të vazhdojnë qasjen derë më-derë, ndërsa të tjerët sugjeruan që komuna të krijojë një bazë të dhënash me informacione kontakti. Kjo e fundit do t'u siguronte atyre mjete për të kontaktuar përfaqësuesit e tyre të zgjedhur për çështjet me të cilat ata ose kolektivi i tyre (lagje, fshatra) mund të përballen.

Edhe pse disa pjesëmarrës shpalosën se disa prej anëtarëve të preferuar të kuvendit (kandidatët për të cilët kishin votuar gjatë zgjedhjeve) ishin zgjedhur, ata ishin bërë "të qetë" pasi që kishin fituar mandatin. Specifikisht, një pjesëmarrëse nga rajoni i Prizrenit pranoi se ajo kishte votuar për një anëtar të familjes (jo familjes së ngushtë). Duke mbajtur besimin se problemet e familjes së saj do të konsideroheshin më shumë, ajo ishte zhgënjyer kur zbuloi se anëtari i përzgjedhur i kuvendit nuk mbajti kontakt me ta, pavarësisht faktit që ky anëtar i kuvendit specifikisht i komunikoi asaj se do ta ndihmonte, sipas pjesëmarrëses.




Figura 23. A keni takuar ndonjë anëtar të kuvendit komunal në 12 muajt e fundit për të diskutuar çështje të përbashkëta publike?

Përveç kësaj, 14% e të anketuarve kanë raportuar se kanë marrë pjesë në seancat e Kuvendit Komunal, ndërsa shumica (86%) kanë treguar se nuk kanë marrë pjesë. Megjithatë, deri në vitin 2023, përqindja e të anketuarve që morën pjesë në seanca të tilla është ulur dukshëm në 6% dhe ata që nuk morën pjesë, u rrit në 94%. Për sa i përket ndarjes nëpër komuna, të anketuarit nga Novobërda, Graçanica, Shtërpca dhe Ranillugu njëzëri deklaruan se nuk kanë marrë pjesë në asnjë seancë të Kuvendit Komunal në 12 muajt e fundit. Në anën tjetër, 68% e të anketuarve në Kllokot raportuan se kishin marrë pjesë në seanca të tilla vitin e kaluar, ndërsa 34% e të anketuarve në Leposaviq, treguan të njëjtën gjë.




Figura 24. A keni marrë pjesë në ndonjë seancë të Kuvendit Komunal në 12 muajt e fundit?

Të anketuarit që kanë marrë pjesë në seancat e Kuvendit Komunal në 12 muajt e fundit kanë raportuar modele të ndryshme të frekuencës. Një numër i konsiderueshëm 30% frekuentonin një herë në vit, ndërsa 26% merrnin pjesë disa herë në vit (por më pak se çdo muaj). Pjesëmarrja mujore ose më e shpeshtë është raportuar nga shtatë përqind, ndërsa 23% kanë marrë pjesë rrallë. Për më tepër, 11% morën pjesë vetëm një herë, dhe 3%e mbetur morën pjesë disa herë, por jo rregullisht.




Figura 25. Sa shpesh keni marrë pjesë në këto seanca?

Duke krahasuar përgjigjet nga viti 2021 me 2023, vërehet një ndryshim i dukshëm në arsyet e ofruara nga të anketuarit për mospjesëmarrje në seancat e Kuvendit Komunal. Në vitin 2021, 43% ia atribuojnë mospjesëmarrjes së tyre mungesës së interesimit, ndërsa kjo përqindje është rritur në 58% në vitin 2023. Në të kundërt, përqindja që përmend mungesë informacioni është ulur nga 37% në 2021, në 18%në 2023. Arsyet për të qenë të zënë mbeti relativisht e qëndrueshme, me një rritje të lehtë nga 20%mnë 23 përqind. Në një ndarje të detajuar, shumica e të anketuarve nga Podujeva (95%), Mamusha (84%), Ranillugu (83%) dhe Vushtrria (81%) treguan mungesë të interesimit për të marrë pjesë në seancat e Kuvendit Komunal. Përafërsisht gjysma e të anketuarve në Zveçan (55%), Deçan (52%) dhe Partesh (50%) raportuan se nuk ishin të informuar për seancat e tilla.

Kishte pak zhgënjim lidhur me këtë temë të veçantë pasi një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve do t'i konsideronin anëtarët e kuvendit (asambleistët) aktivë vetëm gjatë zgjedhjeve. Ata përshkruanin në detaje se si kandidatët për kuvendin komunal do të kishin qasje derë më derë kur mblidhnin vota dhe dëgjonin qytetarët, por në termat e pjesëmarrësve, ata u zhdukën pasi të zgjidheshin. Përveç Pejës, të gjitha rajonet i konsideronin anëtarët e kuvendit si shumë të ndikuar politikisht nga partia e tyre politike dhe më pak në harmoni me nevojat e qytetarëve. Ata do të shtjellonin më tej se një faktor tjetër që ndikon te anëtarët e kuvendit janë të afërmit e tyre, të cilët marrin përfitime specifike. Kështu, vërehej se pjesëmarrësit ishin të zhgënjyer dhe gjithashtu nuk ishin të motivuar për të shikuar seancat e Kuvendit Komunal apo për të marrë pjesë në to.




Figura 26. Cila është arsyeja?

Për më tepër, të anketuarit janë pyetur nëse Kuvendi Komunal arrin ta mbajë ekzekutivin përgjegjës. Thënë kështu, 71%e të anketuarve në vitin 2021 janë pajtuar/plotësisht janë pajtuar me llogaridhënien e Kuvendit, ndërsa në vitin 2023 kjo përqindje ka rënë në 64%. Në një kontekst më specifik, shumica e të anketuarve që pajtohen ose pajtohen plotësisht ishin nga Dragashi (96%), Klina (95%) dhe Peja (94%). Në anën tjetër, ata që nuk pajtohen ose plotësisht nuk pajtohen ishin kryesisht nga Shtërpca (87%) dhe Graçanica (70%).




Figura 27. Deri në çfarë mase pajtoheni që Kuvendi i Komunës arrin të mbajë përgjegjës ekzekutivin e komunës (Kryetarin e komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale)?

Menaxhimi i Komunës

Ky segment ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të dhënave të mbledhura nga të gjitha komunat në Kosovë lidhur me mendimet e qytetarëve për menaxhimin komunal. Pjesëmarrësit e anketës shprehin nivelet e tyre të kënaqshmërisë me aspekte të ndryshme, duke përfshirë menaxhimin e buxhetit komunal, projektet e infrastrukturës publike dhe pikëpamjet e tyre për proceset e rekrutimit (punësimit) brenda komunave.

Nivelet e kënaqshmërisë me menaxhimin e buxhetit komunal mbetën relativisht të njëjta brenda dy viteve. Konkretisht, 67% e të anketuarve të kombinuar në vitin 2021 shprehën kënaqshmërinë me menaxhimin e buxhetit komunal – ndërsa 28% të kombinuar, raportuan të kundërtën. Po kështu, 63% e të anketuarve në vitin 2023 raportuan nivele të kënaqshmërisë, ndërsa pjesa tjetër ishin të pakënaqur (27%). Të anketuarit në Junik (88%), Suharekë (84%), Malishevë (83%), Rahovec (82%) dhe Istog (80%) shprehën nivelet më të larta të kënaqshmërisë. Në anën tjetër, të anketuarit në Shtërpcë (94%), Ranillug (73%) dhe Novobërdë (67%) ishin më së paku të kënaqur me menaxhimin e buxhetit komunal.

Në disa raste, pjesëmarrësit vunë re se buxheti i komunës është rritur këtë vit (2023) (Prishtinë, Viti). Megjithatë, këto do të ishin kontradiktore pasi, gjatë gjithë diskutimit, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit raportuan se nuk ishin të informuar për buxhetin komunal. Megjithatë, ata morën përgjegjësinë për mungesën e këtij informacioni.




Figura 28. Sa jeni të kënaqur me menaxhimin e buxhetit komunal?

Bazuar në rezultatet, ka pasur një ulje të lehtë të përqindjes së të anketuarve që shprehin pakënaqshmëri me cilësinë e punës brenda komunës së tyre nga 30% në 2021, në 26% në 2023. Nga ana tjetër, nivelet e kënaqshmërisë pësuan një rritje të vogël nga 69%në 2021, në 72%në vitin 2023. Të anketuarit nga Ferizaji (94%), Leposaviqi (93%), Suhareka (91%), Parteshi (90%) dhe Dragashi (90%) ishin më së shumti të kënaqur me cilësinë e punimeve në komunën e tyre.

Nga ana tjetër, kur analizohet kohëzgjatja e punës, ka pasur një rritje modeste të pakënaqshmërisë, duke u rritur nga 34% në vitin 2021, në 40% në vitin 2023. Ndërkohë, nivelet e kënaqshmërisë kanë mbetur relativisht të qëndrueshme, me një rënie nga 64% në vitin 2021, në 58% në vitin 2023. Të anketuarit në Suharekë (89%), Malishevë (89%), Ferizaj (87%), Mitrovicë e Veriut (86%) dhe Partesh (81%) shfaqën nivele më të larta të kënaqshmërisë me kohëzgjatjen e punës në projektet e infrastrukturës publike.

Sa i përket përpjekjeve për mbrojtjen e mjedisit, të dhënat e vitit 2023 tregojnë pakënaqshmëri në 27 përqind, ndërsa nivele të kënaqshmërisë në 70 përqind. Aspekti i përpjekjeve për mbrojtjen e mjedisit brenda komunave ka marrë nivelet më të larta të kënaqshmërisë në Suharekë (94%), Malishevë (94%), Istog (91%) dhe Pejë (90%).




Figura 29. Sa jeni të kënaqur me projektet/punimet e infrastrukturës publike në komunën tuaj?

Megjithatë, gjatë diskutimeve në fokus grupe, projektet e infrastrukturës u konsideruan më negative. Megjithëse shumica e pjesëmarrësve në diskutimet e fokus grupeve ishin në dukje të kënaqur që po punohej, pati disa vërrejtje për mungesën e vazhdimit të projekteve.

Një rast i tillë është vërejtur në rajonin e Gjilani, ku shumica e pjesëmarrësve kanë raportuar se shumë nga investimet kapitale të planifikuara nuk janë realizuar siç është diskutuar gjatë zgjedhjeve. Pjesëmarrësit veçanërisht përmendën autostradat dhe rrugët lidhëse. Një pjesëmarrës tregoi se si ankesat e tyre për një rrugë të caktuar nuk u morën parasysh derisa qytetarët bllokuan rrugën në shenjë proteste.

Ngjashëm, një rast është vërejtur në Gjakovë dhe fshatrat përreth. Ankesa të veçanta ka pasur nga fshati Rugovë ku hyrja në fshat bëhet përmes një rruge të gabuar. Përveç kësaj, disa të tjerë ngritën çështjen e mungesës së mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, siç janë kalldërmat (rrugët me kocka). Pjesëmarrësit e konsideruan këtë si një humbje të autenticitetit për fshatin dhe rajonin, dhe ankesat e tyre nuk u dëgjuan. Kjo kishte ndikim në kënaqshmërinë e tyre.

Megjithatë, këto ishin raste shumë specifike të përmendura gjatë diskutimeve që nuk ndikuan plotësisht në nivelin e kënaqshmërisë së pjesëmarrësve. Kjo u konstatua pasi të gjithë pjesëmarrësit raportuan se puna më e madhe është bërë në infrastrukturë në të gjitha qytetet. Megjithatë, duket se puna është bërë kryesisht në qendrat e qyteteve dhe përjashton fshatrat që kanë nevojë për rrugë dhe trotuare më të mira.

> ***"Po, ata [komuna] fokusohen në estetikën e qendrës kryesore. Por kjo zbehje e lagjeve plot identitet në qendër, dhe ndërtimi i ndërtesave 5+ kate, pa infrastrukturë adekuate. Kjo është e papranueshme."***
>
> ***- Pejë (Grua)***

Punësimi nëpër komuna

Një shtesë në mbledhjen e të dhënave ishte një vështrim më i thellë i situatës me punësimin në rajonet përkatëse dhe komunat e tyre. Mbledhja e të dhënave sasiore (kualitative) mblodhi vetëm të dhëna për kriteret e perceptuara nga qytetarët në proceset e rekrutimit të punonjësve komunalë. Megjithatë, metodat cilësore (kualitative) u shtrinë më tej për të kuptuar më mirë perceptimin dhe kënaqshmërinë e qytetarëve me punësimin brenda komunave të tyre.

Vëzhgimet e përgjithshme në të gjitha diskutimet e fokus grupeve nxjerrin në pah se diskutimet u fokusuan kryesisht në punësimin, pavarësisht nga tema. Kur u diskutua për punësimin e përgjithshëm, shumica e pjesëmarrësve e lidhën tendencën e të rinjve për t'u larguar nga vendi me mungesën e mundësive të punësimit dhe mundësive të tjera për zhvillim profesional. Rajoni i vetëm me përjashtim ishte ai i Prishtinës, ku pjesëmarrësit nuk e shtjelluan më tej papunësinë si çështje dhe në përgjithësi ishin të kënaqur.

> ***"Punësimi, si këtu, ashtu edhe në çdo pjesë të Kosovës, është problem. Dhe migrimi është pasojë e kësaj papunësie."***
>
> ***Dragash (Burrël)***

Pjesëmarrësit më të rinj në Prizren gjithashtu theksuan se si kjo ndikon në motivin e tyre për të qëndruar në vend dhe për të jetuar jetën e tyre në Kosovë, veçanërisht në Prizren.

> ***"Si të mos demoralizohet rinia tani? Sepse nëse dikush dëshiron të pyesë për një punë, shkon në komunë. Sepse para votimit kanë premtuar punësim, vetëm për interesin e tyre. Tani, të gjithë të rinjtë shkojnë, bëjnë ankesë dhe nuk merret parasysh. Pse duhet dikush të interesohet tani për diçka tjetër, kur askush nuk të kushton vëmendje?"***
>
> ***Prizren (Burrë)***

Shkalla më e lartë e pakënaqshmërisë duket se është në rajonin e Pejës, Prizrenit dhe Gjakovës. Për Gjakovën, pjesëmarrësit gjithashtu u pajtuan se përveç papunësisë së popullatës së përgjithshme, nuk ka shumë përfshirje dhe shumëllojshmëri në fuqinë punëtore aktuale. Ata vunë në dukje se shumëllojshmëria mund të vërehet vetëm në bizneset private të bazuara në shërbimin ndaj klientit dhe jo aq shumë në pozicione më të larta menaxheriale. Përveç kësaj, hendeku (zbrazëtia) më i madh gjinor është vërejtur në Gjakovë pasi që shumica e grave nuk kanë raportuar interes të veçantë për të punuar. Më pas, kjo veçanërisht është vërejtur tek gratë e moshës më të moshuar.

"Për gratë me hixhab/mbulesë [që praktikojnë Islamin], veçanërisht në vende publike me hyrje dhe dalje të qytetarëve, si supermarkete, nuk kam parë asnjë, përveçse në markete (dyqane) të vogla. Në qendrat e mëdha tregtare nuk kam parë asnjë grua të mbuluar. Mund të ketë pakica dhe është krejtësisht normale të jesh pjesë e kompanive të ndryshme, por nuk i kam parë në pozita të mira, vetëm si staf për mirëmbajtjeje."

- Gjakovë (Grua)

Për më tepër, pjesëmarrësve iu kërkua të zgjerohen në punësimin brenda komunës, dhe mënyrën si ata besojnë se procesi i rekrutimit shkon. Kishte një shpërndarje të përgjigjeve ku pjesëmarrësit përgjithësisht besonin se zyrtarët komunalë mund të zgjidhen në bazë të meritës ose të jenë të lidhur politikisht në një farë mënyre. Për këtë nën-temë, përjashtim ishte rajoni i Prishtinës pasi që nuk e shtjelluan më tej këtë, përveç mundësive që u ofrohen grupeve të margjinalizuara për të qenë pjesë e stafit të komunës. Lidhur me këtë të fundit, pjesëmarrësit në Prishtinë në përgjithësi u pajtuan se mundësitë u ofrohen shumicës së grupeve të margjinalizuara, duke vënë theksin tek komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Në aspektin sasior (kuantitativ), sa i përket kritereve të konsideruara gjatë procesit të rekrutimit për punonjësit komunalë, shumica e të anketuarve në vitin 2021 dhe 2023 (64% dhe 63%) besonin se përkatësia politike ishte një kriter i rëndësishëm. Lidhjet familjare u konsideruan të rëndësishme me 54% në vitin 2021, dhe kjo përqindje u rrit me dhjetë pikë përqindjeje në 2023 (64%). Ndërsa përvoja e punës u identifikua si një kriter tjetër, pati një rënie të lehtë të rëndësisë së tyre të perceptuar. Në vitin 2021, përvoja e punës u konsiderua e rëndësishme me 43% në vitin 2021, e cila është ulur në 37% në vitin 2023. Nivelet e arsimit mbetën të ngjashme në të dyja valët (44% në 2021 dhe 43% në 2023).

Kryesisht, të anketuarit nga Malisheva dhe Podujeva thanë se niveli i arsimit (95% dhe 93%) dhe eksperienca (përvoja) e punës (89% në secilën komunë) janë kriteret kryesore që merren parasysh në procesin e rekrutimit të punëtorëve. Përkatësia politike u konsiderua si kriter kryesor në Shtërpcë (100%), Gjakovë (97%), Deçan (96%), Partesh (96%), Junik (95%), Novobërdë (93%), dhe Rahovec (92%). Po ashtu, lidhjet familjare janë konsideruar si kriter kryesor në Shtërpcë (98%), Gjakovë (92%), Malishevë dhe Ferizaj (88%).




Figura 30. Sipas jush, cilat kritere merren parasysh gjatë procesit të rekrutimit të punonjësve në komunë?

Të anketuarit u pyetën gjithashtu për perceptimin e tyre për përkushtimin e komunës së tyre për të promovuar (nxitur) një mjedis gjithëpërfshirës dhe pranues, pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike apo paaftësia. Një numër mbizotërues prej 56%i njohin përpjekjet

e vazhdueshme në promovimin e një mjedisi gjithëpërfshirës, por mendojnë se ka vend për përmirësim. Në të kundërt, 18%kanë një pikëpamje pozitive, duke besuar se komuna e tyre kultivon në mënyrë aktive një mjedis gjithëpërfshirës. E kundërta, 17%shprehin një ndjenjë negative, duke thënë se komuna e tyre nuk mund të promovojë mjedis gjithëpërfshirës të vërtetë. Përveç kësaj, tetë%mbeten të pasigurt në lidhje me përpjekjet e komunës së tyre për mjedis gjithëpërfshirës.

Në komunat që promovojnë (nxisin) aktivisht një mjedis gjithëpërfshirës, Klina prinë me 80%, e ndjekur nga Mitrovica e Veriut me 76% dhe Zveçani me 74%. Për komunat me hapësirë për përmirësim, Lipjani kryeson me 80%, e ndjekur nga Gllogovci me 74% dhe Ferizaji me 73%. Shtërpca ka përqindjen më të lartë (70%) të të anketuarve që besojnë se komuna e tyre nuk e promovon (nxit) në mënyrë efektive mjedisin gjithëpërfshirës, e ndjekur nga Podujeva me 54% dhe Novobërda me 52%. Sa i përket pasigurisë rreth përpjekjeve të komunës, Zubin Potoku prinë me 53%, e ndjekur nga Vushtrria me 30% dhe Shtërpca me 28%.




Figura 31. A mendoni se komuna juaj promovon një mjedis komunal që është gjithëpërfshirës dhe pranues për të gjithë (pavarësisht gjinisë, përkatësisë etnike, (pa)aftësisë, etj.)?

Gjetjet më tej zbulojnë perceptimet e të anketuarve për mundësi të barabarta për grupe të ndryshme të margjinalizuara në sigurimin e pozitave udhëheqëse në arsim, shëndetësi, institucione kulturore dhe pozita politike në komunë. Grafiku i mëposhtëm tregon se komunat në përgjithësi ofrojnë mundësi udhëheqëse për grupe të ndryshme të margjinalizuara deri në një masë. Për gratë, 43% e të anketuarve besojnë se ka mundësi deri diku të barabarta, ndërsa 25% shohin mundësi të mëdha. Të moshuarit përballen me skepticizëm, me 23% që deklarojnë aspak mundësi dhe 22% perceptojnë shumë pak. Personat me aftësi të kufizuara hasin perceptime të përziera, ku 35% shohin mundësi deri diku të barabarta dhe 18% besojnë në një masë të madhe. Komunitetet jo-shumicë apo 36% e tyre deklaruan mundësi deri diku të barabarta, dhe 23%besojnë se ka mundësi më të mëdha për pozita udhëheqëse.

Kur analizohet në nivel komunal, anketa nënvizon një konsensus të fortë për nevojën për barazi gjinore në rolet udhëheqëse, me marrëveshje pothuajse unanime në mesin e të anketuarve në Klinë (98%), Dragash (97%), Kllokot (95%), Suharekë (94%), dhe Leposaviq (90%). Në kontekstin e ofrimit të mundësive për udhëheqje për të moshuarit, përqindje të dukshme e favorizojnë këtë nëpër komuna të ndryshme, veçanërisht në Klinë (97%), Kllokot (95%) dhe Suharekë (93%). Sa i përket mundësive për udhëheqësi për individët me aftësi të kufizuara, Kllokoti kryeson me 95%, i ndjekur nga Suhareka me 92% dhe Klina me 91%. Një ndjenjë mbizotëruese nëpër komuna të ndryshme është përkushtimi për të ofruar mundësi të barabarta udhëheqëse për pakicat etnike. Edhe një herë, Klina (96%), Kllokoti (95%) dhe Peja (91%) dalin me marrëveshje të konsiderueshme, duke reflektuar qëndrime pozitive ndaj gjithëpërfshirjes dhe shumëllojshmërisë në këto rajone.




Figura 32. A konsideroni se komuna juaj u ofron grupeve të ndryshme të margjinalizuara mundësi të barabarta për pozita udhëheqëse (arsim, shëndetësi, institucione kulturore dhe pozita politike në komunë)?

Ofrimi i Shërbimit

Ky seksion i raportit do të prezantojë gjetjet e studimit në lidhje me shërbimet komunale të shfrytëzuara nga qytetarët e Kosovës dhe nivelet përkatëse të kënaqshmërisë së tyre me këto shërbime.

Sipas gjetjeve të anketës, ka ndryshime në përdorimin e shërbimeve të ndryshme komunale gjatë 12 muajve të fundit, duke krahasuar përgjigjet nga viti 2021 deri në vitin 2023. Në shërbimet administrative shihet një ulje të përdorimit nga 77% në 2021 në 66% në vitin 2023. Veçanërisht, 72% e të anketuarve burra përdornin shërbime administrative, në dallim nga 60% e të anketuarvegra. Në të kundërt, shërbimet shëndetësore parësore kishin një rritje nga 69% në 73%. Hapësirat publike, si parqet dhe teatrot, e rritën ndjeshëm përdorimi nga 49% në 68%. Shërbimet e arsimit para-universitar mbetën relativisht të qëndrueshme, duke u rritur lehtësisht nga 47% në 49%.

Për më tepër, përdorimi i transportit publik u rrit nga 40% në 44%. Lejet e ndërtimit pësuan një rënie të dukshme të përdorimit nga 15% në gjashtë përqind.

Analizimi i shfrytëzimit të shërbimeve komunale në 12 muajt e fundit thekson modele të ndryshme në të gjitha komunat. Gjetjet e dukshme përfshijnë angazhimin e lartë me shërbimet administrative në Dragash (98%) dhe Mitrovicë e Veriut (97%), për dallim nga përdorimi më i ulët në Pejë (26%) dhe Shtërpca (27%). Shërbimet e lejeve të ndërtimit kanë adoptim të konsiderueshëm në Mitrovicën e Veriut (90%) dhe Zveçan (86%), ndërsa Podujeva dhe Shtërpca nuk raportojnë përdorim. Shërbimet shëndetësore primare vërejnë pjesëmarrje aktive të të anketuarve nga Mitrovica e Veriut, Ranillug dhe Kaçaniku (të gjithë 96%), por një shfrytëzim dukshëm më i ulët në Zubin Potok (10%). Transporti publik dëshmon përdorim të lartë në Shtërpcë (99%) dhe Prishtinë (96%), me përdorim minimal në Skenderaj (0%) dhe Podujevë (2%). Arsimi para-universitar sheh angazhim të konsiderueshëm në Mitrovicën e Veriut dhe Novobërdë (96% dhe 87%), por pjesëmarrje të kufizuar në Klinë (3%) dhe Zubin Potok (2%). Të anketuarit përdorin në mënyrë aktive hapësirat publike në Ranillug (100%) dhe Podujevë (99%), ndërsa Zubin Potoku dhe Klina janë shumë më të ulëta (1% dhe 5%).

Diskutimet në fokus grupe nxorën shërbimet administrative si më të përdorurat në të gjitha komunat, ndërsa shërbimet shëndetësore ishin të radhës më të përdorurat. Këto ishin shërbime e njëjta më të përmendura në të gjitha rajonet dhe komunat.




Figura 33. A keni përdorur shërbimet komunale të mëposhtme në 12 muajt e fundit?

Kënaqshmëria më e lartë me shërbimet ishte e ngjashme në të gjitha komunat, dhe ishte për shërbimet administrative për dokumente të ndryshme, ku disa pjesëmarrës pohonin me kokë dhe lavdëronin dixhitalizimin e shumicës së procedurave. Shumica e pjesëmarrësve në të gjitha komunat zbuluan se ka pasur përmirësime të mëdha në institucionet publike të kujdesit shëndetësor, me faktorë të tillë si qëndrimet (sjelljet) ndaj pacientëve dhe kushtet e përgjithshme janë përmirësuar.

Për më tepër, nivelet e kënaqshmërisë me shërbime të ndryshme komunale, të vlerësuara në një shkallë nga 1 në 4, kanë treguar zhvendosje nga viti 2021 në 2023. Për arsimin para-universitar, ka një rënie të të anketuarve të pakënaqur (21% dhe 16%) dhe një rritje e të kënaqurve (72% në 84%) nga viti 2021 deri në 2023. Në shërbimet shëndetësore ka një rritje të të anketuarve që janë shprehur të kënaqur nga viti 2021 në 2023 (68% në 79%). Shërbimet administrative kanë rënë tek ata që janë deri diku të kënaqur (52% në 48%) dhe një rritje e atyre që janë plotësisht të kënaqur (30% në 43%) nga 2021 në 2023. Përqindja e të anketuarve që janë plotësisht të kënaqur me infrastrukturën rrugore ka mbetur e njëjtë (24% në 2021 dhe 2023). Transporti publik pësoi një rënie të vogël të atyre që janë plotësisht të pakënaqur (10% në 7%) dhe një rritje të atyre që ishin plotësisht të kënaqur (24% në 32%) nga 2021 në 2023. Së fundi, 74% e të anketuarve (n=422) treguan nivele të kënaqshmërisë në lidhje me lejet e ndërtimit. Për më tepër, një përqindje më e lartë e të anketuarëve meshkuj treguan kënaqshmëri me lejet e ndërtimit (77%) dhe hapësirat publike (76%) në krahasim me të anketuarat femra (69% dhe 70%).

Sa i përket shërbimeve administrative, Graçanica ka një shkallë të kënaqshmërisë deri diku/plotësisht të kënaqur prej 32%, ndërsa Shtërpca dhe Zveçani tregohen plotësisht të kënaqur prej 100% Lejet e ndërtimit ngjallin pakënaqshmëri të plotë në Graçanicë dhe Novobërdë (100%), ndërsa disa komuna, duke përfshi Gllogovci, Lipjani, Han i Elezit, Malisheva, Shtimja, Mamusha, Peja, Skenderaji dhe Fushë Kosova, raportojnë për kënaqshmëri të 100%. Shërbimet shëndetësore parësore gjenerojnë një shkallë të pakënaqshmërisë prej 74% në Ranillug, ndërsa Shtërpca dhe Suhareka tregojnë kënaqshmëri më të lartë në 98% dhe respektivisht 99%. Pakënaqshmëria e transportit publik vërehet në Klinë (69%) dhe Graçanicë (58%), në kontrast me plotësisht të kënaqur në Malishevë, Zubin Potok, Suharekë

dhe Pejë. Pakënaqshmëria e arsimit para-universitar ndryshon, me Ranillug dhe Shtërpcë që shfaqin nivelin më të lartë të pakënaqshmërisë (72% dhe 85%). Në anën tjetër, Suhareka (98%) ka treguar deri diku/plotësisht të kënaqur. Pakënaqshmëria me hapësirat publike është e dukshme në Ranillug (86%) dhe Shtërpcë (85%), ndërsa Zubin Potoku regjistron kënaqshmëri prej 100%. Sa i përket infrastrukturës rrugore, Mitrovica e Jugut dhe Ranillugu shfaqin shkallë të pakënaqshmërisë prej 73% dhe respektivisht 68%, ndërsa Istogu dhe Suhareka raportojnë shkallë më të ulët të pakënaqshmërisë në 3%dhe 4%.

Ndërsa shërbimet specifike komunale me më së paku kënaqshmëri, ishin angazhimi i të rinjve në Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Gjilan. Më të përmendurat në Prizren dhe Gjilan ishin objektet sportive. Pjesëmarrësit më të rinj në fokus grupin e Prizrenit theksuan se ekziston vetëm një palestër dhe ajo është e pamjaftueshme. Ndërkaq, në Gjilan mungesën e aktiviteteve ia atribuojnë të rinjve, që janë kontribuuesi kryesor që të rinjtë të largohen nga vendi.

Në të kundërt, më së paku të kënaqur me shërbimet në Pejë ishin lejet e ndërtimit pasi që banorët e Pejës dhe fshatrave përreth nuk i konsideronin lejet e ndërtimit si transparente dhe me integritet. Ata e shtjelluan këtë duke thënë se si mund të ndikojnë marrëdhëniet familjare dhe interesat politike në lejet e shërbimeve të komunës për ndërtime aty ku nuk duhet të ketë.

Tabela 1. Në një shkallë nga 1 deri në 4, ku 1 - aspak i kënaqur, 2 - Disi i pakënaqur, 3 - Deri diku i kënaqur dhe 4 - plotësisht i kënaqur, ju lutemi vlerësoni nivelin tuaj të kënaqshmërisë me shërbimet komunale të mëposhtme.

		Plotësisht i pakënaqur	Deri diku i pakënaqur	Deri diku i kënaqur	Plotësisht i kënaqur	Refuzoj/Nuk kam mendim
Arsimi para-universitar	2021	4%	18%	45%	27%	6%
	2023	3%	12%	56%	28%	1%
Shërbimet shëndetësore	2021	4%	25%	42%	26%	3%
	2023	5%	17%	47%	32%	0%
Hapësirat publike (parqe, teatro, fusha sportive, etj.)	2021	5%	17%	49%	23%	6%
	2023	7%	20%	47%	26%	0%
Shërbimet administrative	2021	5%	11%	52%	30%	3%
	2023	3%	6%	48%	43%	0%
Infrastruktura rrugore (rrugët lokale dhe trotuaret)	2021	5%	17%	47%	24%	6%
	2023	7%	18%	49%	24%	1%
Transporti publik	2021	10%	17%	42%	24%	7%
	2023	7%	17%	44%	32%	0%
Lejet e ndërtimit	2023	7%	17%	42%	32%	2%

Nivelet e kënaqshmërisë me planifikimin hapësinor, duke përfshi zhvillimin komunal dhe planifikimin e përdorimit të tokës, kanë treguar zhvendosje margjinale nga viti 2021 në 2023. Veçanërisht, ka një rritje të lehtë të të anketuarve që shprehen plotësisht të pakënaqur (5% në 8%), një rënie e të anketuarve në deri diku të pakënaqur (21% në 16%), dhe një rritje e vogël në të anketuarit plotësisht të kënaqur (11% në 10%). Shumica e të anketuarve në të

dy vitet tregojnë një nivel kënaqshmërie, me "Deri diku i kënaqur" që është përgjigja më e përhapur (58% në 2021 dhe 59% në 2023).

Sa i përket planifikimit hapësinor, Shtërpca veçohet me shkallën më të lartë të pakënaqshmërisë prej 99%. Në vijim nga afër është Ranillugu, duke shfaqur një nivel të dukshëm pakënaqshmërie prej 87%. Në anën tjetër, Klina dhe Mamusha dallohen për pritjen e tyre pozitive, me 94%dhe respektivisht 93% të shkallës së kënaqshmërisë.




Figura 34. Sa jeni të kënaqur me planifikimin hapësinor (zhvillimi komunal dhe planifikimi i përdorimit të tokës)?

Kënaqshmëria e përgjithshme me komunat

Ndër aspektet tjera, ky studim u mundësoi të anketuarve të vlerësojnë dhe kategorizojnë nivelet e tyre të kënaqshmërisë në lidhje me performancën e përgjithshme të komunave, Kryetarit të komunës, Kuvendit Komunal, administratës lokale dhe shërbimeve komunale.

Vlerësimi i niveleve të kënaqshmërisë në qeverisjen komunale, duke u fokusuar veçanërisht tek të anketuarit që u shprehen "Deri diku i kënaqur» ose «Plotësisht i kënaqur", tregon një shkallë mesatare të kënaqshmërisë prej 73% në vitin 2021. Kjo shifër pësoi një rritje të lehtë, duke arritur në 76% në vitin 2023, duke përjashtuar në përgjithësi matjet e performancës. Duke shqyrtuar dimensionet specifike, kënaqshmëria me shërbimet komunale u rrit nga 78% në 2021, në 83%në 2023. Ngjashëm, kënaqshmëria me administratën lokale u rrit nga 75% në 2021, në 78% në 2023. Megjithatë, Kuvendi Komunal kishte një rënie të lehtë nga 71% në 2021, në 69% në 2023.

E kundërta, kënaqshmëria me kryetarin e komunës u rrit nga 66% në 2021, në 73% në 2023. Ekziston një ndjenjë përgjithësisht pozitive ndaj Kryetarit në mesin e grup-moshave të ndryshme, me demografi tek të moshuarit (65+) që shprehin nivelet më të larta të kënaqshmërisë (76%). Grup-mosha 55-64 qëndron në atë se ka një përqindje relativisht më të lartë të pakënaqshmërisë në krahasim me të tjerët (27%). Në përgjithësi, përqindja e kombinuar e kënaqshmërisë për performancën e komunës u rrit nga 75%në 2021, në 80% në 2023.

Nëpër komuna, kënaqshmëria me entitetet dhe shërbimet kyçe komunale ndryshon dukshëm. Banorët e Shtërpcës shprehin pakënaqshmëri dërrmuese me Kryetarin dhe Kuvendin e Komunës, respektivisht 98%dhe 96%.

Sa i përket administratës lokale, Graçanica dhe Ranillugu tregojnë shkallë të pakënaqshmërisë prej 73% dhe 64%. Në krahasim, Klina dhe Shtime shfaqin nivele më të larta të kënaqshmërisë me administratën lokale në 98% dhe 95%.

Sa i përket shërbimeve komunale, banorët e Ranillugut (80%) dhe Graçanicës (73%) janë kryesisht të pakënaqur, ndërsa Lipjani (98%) dhe Shtime (97%) tregojnë nivele të larta të kënaqshmërisë.

Përveç gjetjeve sasiore, administrata lokale u vlerësua shumë gjatë diskutimeve në fokus grupe krahas shërbimeve komunale. Në të njëjtën kohë, kishte dallime të mëdha në lidhje me kryetarët e komunave. Pjesëmarrësit nga komuna e Gjakovës në përgjithësi ishin më të kënaqur me kryetarin e tyre pasi vazhdimisht e duartrokisnin për punën që ka bërë deri më tani. Kjo kënaqshmëri u pasua nga Mitrovica dhe Klina, të cilët raportuan se në përgjithësi ishin më të kënaqur me të gjitha aspektet, por u siguruan që të specifikojnë përpjekjet e kryetarëve të komunave për të përmirësuar shërbimet dhe performancën.

Ndërkohë, në Pejë, pjesëmarrësit në përgjithësi ishin të irrituar dhe të pakënaqur me kryetarin e komunës pasi i referoheshin infrastrukturës, planifikimit urban dhe menaxhimit të fatkeqësive. Këtë gjë ia atribuan kryetarit pasi besonin gjerësisht se të gjitha të përmendurat më sipër ndjekin një zinxhir, maja e të cilit është kryetari i komunës. Në Viti ka pasur pakënaqshmëri me kryetarin e komunës pasi që ai ka qenë atje për tre mandate dhe nuk ka ndjekur shumë projekte gjatë këtyre mandateve përkundër premtimeve të tij në periudhat zgjedhore. Kështu, kjo mospërmbushje e qëllimeve/ premtimeve të caktuara nga kryetari i zhgënjeu qytetarët.




Figura 35. Ju lutemi vlerësoni nivelin tuaj të kënaqshmërisë si në vijim:

Banorët e komunës në përgjithësi shprehin kënaqshmëri të moderuar me aspekte të ndryshme të mjedisit të tyre të jetesës, siç tregohet nga pikët mesatare në një shkallë nga 1 në 5. Cilësia e ajrit merr një vlerësim relativisht më të lartë të kënaqshmërisë, me një rezultat mesatar prej 3.34, që sugjeron një nivel të dukshëm kënaqshmërie. Megjithatë, kënaqshmëria në trafik është më e ulët, me një rezultat mesatar prej 2.94, që tregon një ndjenjë më pak të favorshme. Përpjekjet për menaxhimin e mbeturinave dhe për mbrojtjen e mjedisit marrin kënaqshmëri të moderuar, me rezultate mesatare përkatësisht 3.29 dhe 3.10. Menaxhimi i fatkeqësive, me një rezultat mesatar prej 3.03, gjithashtu bie brenda intervalit mesatar të kënaqshmërisë.

Lidhur me këtë, pjesëmarrësit në fokus grupe theksuan kënaqshmëri me menaxhimin e mbeturinave, i cili i plotëson të dhënat sasiore. Ata veçanërisht theksuan se komunat janë përmirësuar me kompanitë që kontraktojnë. Megjithatë, ata përmendën në mënyrë të veçantë mungesën e ndërgjegjësimit dhe konsideratës së qytetarëve të tjerë për hedhjen e mbeturinave, gjë që e bën më të vështirë. Prandaj, ata u pajtuan duke vënë theks në dualitetin e kësaj dhe sa shumë qytetarët ndikojnë në menaxhimin e mbeturinave.

Në Prishtinë, pjesëmarrësit në përgjithësi ishin të pakënaqur me cilësinë e ajrit dhe trafikun, ndërsa përmendën se rregullimet e reja në sheshin e qytetit kanë ndikuar jashtëzakonisht shumë në lëvizjen nëpër qytet. Ndërsa në Pejë ka pasur pakënaqshmëri të madhe me menaxhimin e fatkeqësive. Pjesëmarrësit nga rajoni i Pejës i referohen veçanërisht përmbytjeve të fundit në vitet e fundit. Sipas tyre, përpjekjet e komunës nuk janë vënë re aq shumë pasi këto vërshime janë të shpeshta dhe kërkojnë një zgjidhje të përhershme.

Të dhënat e ndara sipas komunave tregojnë se Klina prinë në kënaqshmërinë e cilësisë së ajrit me rezultatin më të lartë prej 4.86, e ndjekur nga Shtërpca dhe Istogu me 4.83. Sa i përket cilësisë së ajrit, Zubin Potoku është veçanërisht komuna më pak e kënaqur, me rezultatin më të ulët prej 1.43, e ndjekur nga Obiliqi (1.72) dhe Prishtina (2.20). Kënaqshmëri të lartë me menaxhimin e trafikut është Istogu me 3.97 pikë, i ndjekur nga Dragashi (3.81) dhe Malisheva (3.65). Në anën tjetër, Ranillugu dhe Prishtina janë komunat më së paku të kënaqura me trafik, me rezultate 2.07 dhe respektivisht 2.20, me Fushë Kosovën me 2.32. Tutje, Klina

kryeson në kënaqshmërinë e menaxhimit të mbeturinave me një rezultat mbresëlënës prej 4.97, e ndjekur nga Istogu dhe Peja me 4.78 dhe 3.97. Ndërkohë, Kllokoti dhe Ranillugu barazojnë për më pak të kënaqur në menaxhimin e mbeturinave, të dyja me 2.09 pikë. Për më tepër, Istogu kryeson për sa i përket përpjekjeve për mbrojtjen e mjedisit, me 4.51 pikë, i ndjekur nga Klina dhe Suhareka me 4.20 dhe 3.90. Në këtë aspekt, komuna më pak e kënaqur është Shtërpca me 1.89 pikë, e ndjekur nga Zubin Potoku dhe Kllokoti me 1.95 dhe 2.01. Përfundimisht, Dragashi është më i kënaqur me menaxhimin e fatkeqësive, me 4.14 pikë, i ndjekur nga Lipjani dhe Istogu me 3.89 dhe 3.85. Shtërpca është komuna më pak e kënaqur në menaxhimin e fatkeqësive, me 1.70 pikë, e ndjekur nga Zubin Potoku (2.13) dhe Graçanica (2.14).




